

BASHKIA MIRDITË

PLANI SOCIAL 2024-2026



Përgatitja e Planit Social të Bashkisë Mirditë u mundësua nga mbështetja e Programit “Leave No One Behind” i Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë.

Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendrore programi LNB po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet Sociale Lokale. Ligji nr. 121/2016 “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së këtyre Planeve bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre. Edhe pse qeverisja lokale ka tashmë një nivel të ngritur të ndërgjegjësimit mbi nevojën për të ngritur e bërë funksional një sistem komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për ata që kanë nevojë për këto shërbime, ajo ka kapacitete të kufizuara teknike dhe financiare për ti hartuar dhe kostuar planet e veprimit.

Objekti i këtij programi (2024 – 2026) është fuqizimi i personave dhe grupeve vulnerabël për të patur akses të barabartë në shërbimet publike, për të patur zë në vendimarrjet që ndikojnë mbi jetën e tyre dhe për të kërkuar përgjegjshmëri nga ata që kanë funksione publike. Grupet e targetuara drejtpërdrejtë ose indirekt nga shërbimet e përmirësuara sociale janë popullsia e marginalizuar në Shqipëri, ku ndër grupet më vulnerabël janë më shpesh personat me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët, fëmijët dhe gratë. Përmirësimi i përfshirjes së tyre sociale po mbështetet nga ndërhyrje në nivelin makro (qeveria qendrore dhe shërbimet kombëtare), nivelit lokal (bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile) si dhe në nivelin mikro duke përfshirë aktivisht grupet e targetuara nga projekti në procesin e zbatimit të tij.

PERMBAJTJA

HYRJE	4
1. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE	6
1.1 Vizioni	6
1.2 Misioni.....	6
1.3 Parimet udhërrëfyese.....	6
2. ANALIZA E SITUATËS.....	8
2. 1 Kuadri Strategjik	8
2.2 Vlerësimi i Nevojave për Shërbime	11
2.3 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale	17
2.4 Mangësitë në shërbime	22
2.5 Analiza SWOT	25
3. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	28
4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	46
5. PLANI I VEPRIMIT	47
BUXHETI	68
REFERENCAT	70
SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË.....	72
SHTOJCA 2. NEVOJAT PËR SHËRBIME	86
SHTOJCA 3. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR	92
SHTOJCA 4. BUXHETI I DETAJUAR	95

HYRJE

Mbrojtja dhe përkujdesja për grupet vulnerabël ka qenë dhe mbetet prioritet për Bashkinë Mirditë. Ajo është e angazhuar për të përmbushur të gjitha funksionet e saj në këtë fushë në përputhje me legjislacionin dhe standartet kombëtare e të adresojë cilësisht nevojat në ndryshim të komunitetit vendor për këto shërbime.

Për të mundësuar planifikimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki, e mbështetur nga konsulenca e ofruar në kuadër të Programit “Askush të mos mbetet pas” të UNDP, nisi në Prill 2020 procesin e hartimit të Planit Social Vendor. Hartimit të këtij Plani i parapriu Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, i cili identifikoi grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet egzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimet njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror që në thelb duhet të adresojnë nevojat e këtyre grupeve.

Grupi lokal i Bashkisë i mbështetur nga konsulenti kombëtar përdori përgjatë procesit të identifikimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror kombinim të teknikave të ndryshme: (1) analizë e legjislacionit kombëtar¹, procedurave të punës, Rregullores së Brendshme të Bashkisë; (2) U identifikuan dhe u mblodhën një numër të dhënash statistikore dhe jo statistikore nga institucione kombëtare dhe lokale; (3) Pas identifikimit të grupeve vulnerabël u zhvilluan intervista gjysëm të strukturuar me individë që përfaqësonin karakteristikat kyç të këtyre grupeve, me qëllim identifikimin e se sa dhe si përmbushen aktualisht nevojat e tyre nga shërbimet e kujdesit shoqëror, si dhe nevojave e tyre për shërbime në vijim. (4) U zhvilluan konsultime me institucione publike lokale e rajonale dhe ofrues jopublik shërbimesh me qëllim saktësimin e të dhënave e gjetjeve, si dhe identifikimin e prioriteteve për ngritjen e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Mirditë.

Për 5,959 individë në territorin e Bashkisë Mirditë ose 17% të popullsisë së saj të identifikuar në nevojë për të paktën një nga format e shërbimeve të kujdesit shoqëror u vlerësua domosdoshmëria e ngritjes së një sistemi të koordinuar komunitar shërbimesh kujdesi shoqëror që në periudhën 2024-2026 duhet të adresojë këto prioritete:

¹ Tek Referencat gjeni listën e plotë të paketës legjislative të konsultuar

1. Në kushtet e një niveli të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në këtë Bashki, fuqizimi ekonomik i individëve madhorë të këtyre familjeve duhet të konsiderohet si çështje prioritare. Kjo nuk është një çështje që i përket vetëm Bashkisë, prandaj çdo masë/veprim i parashikuar për këtë qëllim në Planin Social të Bashkisë duhet të përfshijë ndërveprimin mes aktorëve publik e jopublik që kanë përgjegjësi e kapacitete për ta përmbushur këtë synim.
2. Shërbimi i strehimit social duhet gjithashtu të konsiderohet me prioritet për shkak të numrit të lartë të kërkesave dhe vulnerabilitetit të familjeve aplikuese për këtë shërbim.
3. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara duhen vlerësuar me prioritet në Planin Social duke kombinuar shërbimet mbështetëse, zhvilluese e rehabilituese me shërbimet në familje. Në projektet infrastrukturore Bashkia duhet të parashikojë masa konkrete që mundësojnë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në ambiente dhe institucione publike.
4. Dhuna në familje ende nuk denoncohet kudo në territorin e Bashkisë Mirditë, prandaj Plani Social duhet të parashikojë nga një ana masa që nxisin informimin dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve mbi nevojën për ta ndaluar dhe denoncuar dhunën, nga ana tjetër shërbime që adresojnë nevojat e viktimave të dhunës.
5. Plani Social duhet të përfshijë një numër masash që forcojnë mekanizmin ndërsektorial të mbrojtjes së fëmijëve dhe në mënyrë të veçantë identifikimit proaktiv të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Plani duhet të përfshijë shërbime që adresojnë veçanërisht nevojat e fëmijëve dëshmitar apo viktimë e dhunës në familje, fëmijëve të familjeve që jetojnë përmes ndihmës ekonomike dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.
6. Të vlerësohet shpërndarja shërbimeve në përputhje me territorin ku jetojnë familjet dhe fëmijët në nevojë për shërbime.
7. Edhe pse nuk është e mundur aktualisht të vlerësohet madhësia dhe nevojat reale për shërbime për të moshuarit, Plani duhet të parashikojë shërbime për të moshuar që kanë vështirësi financiare, si dhe ata që jetojnë vetëm.
8. Organizimi dhe detyrat e strukturave përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë Mirditë në dy nivelet (Bashki dhe njësi organizative) duhet ti përgjigjen detyrimeve ligjore. Rekomandohet që Plani të parashikojë masa si për riorganizimin e tyre, ashtu dhe adresimin e nevojave të tyre për infrastrukturë, buxhet dhe trainime.

1. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.1 Vizioni

Sistem komunitar i integruar e funksional i shërbimeve të kujdesit shoqëror që nxit zhvillimin, zgjedhjen, pavarësinë, pjesëmarrjen e plotë, efektive dhe të barabartë në jetën komunitare për të gjithë qytetarët që kërkojnë këto shërbime.

1.2 Misioni

Bashkia Mirditë do të ndërtojë një sistem të koordinuar shërbimesh të mbrojtjes dhe kujdesit shoqëror duke alokuar burime njerëzore e financiare dhe ndërtuar partneritet efektiv me institucione e ofrues shërbimesh publik e jo publik me qëllim adresimin cilësor të nevojave të çdo individi që i ka të nevojshëm këto shërbime.

1.3 Parimet udhërrëfyese

Sistemi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Mirditë do të ngrihet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe parimet universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

Parimi i universalitetit

Shërbimet e kujdesit shoqëror do të krijohen, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në sistemin kombëtar të rregullave dhe standarteve që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte. Përveç ngritjes dhe funksionimit të çdo shërbimi sipas standartit kombëtar të miratuar, Bashkia përmes strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror do të monitorojë në mënyrë periodike përmbushjen e tyre nga ofruesit e shërbimit të ngritur apo financiar pjesërisht apo plotësisht nga Fondi Social i Bashkisë.

Parimi i deinstitutionalizimit

Shërbimet e kujdesit shoqëror do të sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

Parimi i partneritetit

Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Mirditë do të bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore. Gjithashtu Bashkia është e angazhuar të zhvillojë përtneritetin aktual me organizatat që punojnë për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe respektimin e të drejtave të tyre, si dhe ta zgjerojë këtë partneritet me çdo organizatë, donatorë, grup interesi apo biznese lokale qëllimet dhe objektivat e të cilave përputhen me ato të këtij Plani Social.

Parimi i drejtësisë sociale dhe mbështetjes shoqërore

Bashkia Mirditë është e angazhuar që për individët që përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, të respektojë të drejtën e tyre për të marrë shërbimet në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

Parimi i mosdiskriminimit

Bashkia është e angazhuar për të mos lejuar asnjë formë të diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij. Individët janë përgjegjës për jetën e tyre, prandaj do të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që ka vendosur shoqëria.

Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe do të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të ruaj konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, për të cilin ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

2. ANALIZA E SITUATËS

2.1 Kuadri Strategjik

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror e kanë rrënjën e tyre tek politikat dhe standartet kombëtare. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 ka reflektuar angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore. Tre janë politikat² e formuluar në këtë strategji mbi të cilat synohet të mundësohet mbrojtje, përfshirje dhe rintegrim social për personat dhe familjet e prekura nga varfëria, si dhe individë në situatë vulnerabiliteti: (1) Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë; (2) Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara; (3) Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social. E përbashkëta e tre politikave qëndron në lidhjen që krijohet tashmë midis programit të pagesave cash (ndihma ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara) me shërbimet e kujdesit shoqëror të cilat në thelb duhet të luajnë një rol kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës së individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë, për fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale. Specifikisht, në këndvështrimin e programit të ndihmës ekonomike, Strategjia thekson se “Duhet rritur ndërlidhjet e shërbimeve ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike, në shëndetësi, arsim, strehim, apo tjetër dhe duhet synuar konsolidimi i një pakete të plotë shërbimesh ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike”³, duke përcaktuar kështu si një nga ndërhyrjet prioritare masa/shërbime për riintegrimin social të përfituesve të Ndihmës Ekonomike. Një nga objektivat e Strategjisë në këndvështrimin e përmirësimit të cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara është “krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në *Cash*, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020”⁴. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, Strategjia e sheh të lidhur me zbatimin e parimit të decentralizimit dhe të deinstitutionalizimit. Synohet ngritja dhe funksionimi i një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore. Në vend të shërbimeve rezidenciale synohet ngritja dhe funksionimi i shërbimeve komunitare që i përgjigjen nevojave të identifikuara të

² Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015- 2020, fq.24, aksesuar në https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf

³ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015- 2020, fq.16, aksesuar në https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf

⁴ Idem, Fq.25

individëve e familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Çdo fëmijë, apo/dhe i rritur, si dhe familje shqiptare duhet të kenë akses të barabartë dhe të përfitojnë nga një sistem funksional dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Bazuar në këtë Strategji, por edhe në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, sikurse Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Bashkitë janë aktorët kryesorë në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar dhe si të tilla ato duhet të kenë kapacitetet e nevojshme veçanërisht në drejtim të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të këtyre shërbimeve.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht: (1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; (2) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; (3) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore; (4) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit. Neni 36 i këtij Ligji ngarkon Bashkinë për të ofruar dhe administruar shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke: identifikuar nevojat; vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; hartuar planin social vendor; programuar buxhetet vendore; planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore; kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

Hartimi i Planit Social nga njësia e qeverisjes vendore është një detyrim që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shoqëror që rrjedh nga ligji i sipërcituar i vjen në ndihmë Bashkisë në procesin e planifikimit të shërbimeve sipas nevojave për mbrojtje dhe përkujdesje ndaj grupeve vulnerabël. Kjo paketë shërbimesh është konsoliduar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e

shërbimit të organizuar”. Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror identifikohen nga Bashkia përmes proceseve konsultuese dhe ato harmonizohen në Planin Social lokal, por shërbimet mund të ofrohen drejtpërdrejtë nga një ofrues publik (Bashkia, Qarku apo SHSSH) ose nga ofrues jopublik. Bashkia duhet të drejtojë jo vetëm procesin e identifikimit të nevojave, por edhe koordinimin e kontributeve që mund të vijnë nga aktorë të ndryshëm publik e jopublik dhe reflektimin e tyre në këtë Plan.

Financimi i shërbimeve është parashikuar gjithashtu në ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe në pikën 2 të VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, sipas të cilit çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: (a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (b) fondet nga buxhetet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; (c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; (ç) tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Jo vetëm ligji, por edhe ky Vendim i Këshillit të Ministrave i sipërcituar kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë me ekzistencën e Planit Social të saj. Ndërkohë VKM 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, ka përcaktuar mekanizmin e financimit nga Qeveria qendrore, si dhe metodologjinë e përllogaritjes së fondeve që do të furnizojnë Fondin Social që ngre Bashkia.

Për të ngritur sisteme komunitare të qëndrueshme të kujdesit shoqëror është e domosdoshme që Bashkia të ketë strukturat e duhura dhe stafe të dedikuara në të dy nivelet e organizimit të saj. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Analiza e kuadrit ligjor⁵ ekzistues të çon në këto role dhe funksione të dy strukturave që duhet të ngrihen e funksionojnë për ta bërë legjislacionin të zbatueshëm:

(1) Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, e krijuar pranë Bashkisë, duhet të sigurojë: drejtimin strategjik, planifikimin, ngritjen, funksionimin, financimin, monitorimin dhe mbështetjen me kapacitete të sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ndërkohë kjo strukturë kryen dhe funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës

⁵ Ligji “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, ndryshuar, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”; Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 (ndryshuar) “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sikurse në përputhje me VKM Nr.334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” ka në përbërje të saj edhe koordinatorin vendor për adresimin e dhunës në familje. Në përputhje me Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, pjesë e kësaj strukture është edhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, e cila ushtron rolet dhe funksione që rrjedhin nga ky ligj.

(2) Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ngrihet⁶ në çdo njësi administrative në varësi të Bashkisë, me përjashtim të Bashkive me më pak se 6 mijë banorë, dhe në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ajo duhet të përmbushë detyra që lidhen me identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë, menaxhimin e rasteve, referimin tek shërbimet, informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim për punësim, për pagesat sociale në të holla; Në përbërje të kësaj Njësie duhet të ketë të paktën: një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10 000 banorë; një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë⁷; një administrator shoqëror⁸;

2.2 Vlerësimi i Nevojave për Shërbime

2.2.1 Të dhëna demografike

Bashkia Mirditë është pjesë e Qarkut Lezhë, shtrihet në një sipërfaqe prej 869,71 km² dhe është e organizuar në 7 njësi administrative, specifikisht Rrëshen, Kaçinar, Rubik, Fan, Kthellë, Selitë, Orosh.

Kjo Bashki ka një popullsi prej 36,094 banorë⁹ dhe 11,840 familje. Mesatarja e pjesëtarëve të një familje është 3,04. Bashkia ka një densitet 41,5 banorë/km².

Sipas Censusit të vitit 2011 Bashkia Mirditë ka 22,103 banorë, pra referuar numrit të popullsisë sipas Gjendjes Civile konkludojmë se 61% e popullsisë jeton fizikisht në territorin e kësaj Bashkie.


⁶ Nenet 36 dhe 37 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

⁷ Kjo në përputhje me Ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

⁸ Detyra sipas Ligjit “Për asistencën sociale”

⁹ Të dhëna të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, prill 2020

Grafik 1. Grup moshat




Siç shihet në grafikun 1, 66% e popullsisë i përket grupmoshës 19-64 vjeç, 22% janë fëmijë 0-18 vjeç dhe 12% e popullsisë përbëhet nga grupmosha mbi 65 vjeç.

Grafik 2: Shpërndarja e popullsisë në territor

Shpërndarja e popullsisë në territor jepet në grafikun 2. Siç shihet 44% e popullsisë jeton në njësitë administrative Rrëshen e Kaçinar¹⁰, e pasuar nga 22% që jeton në Rubik dhe katër njësitë e tjera kanë një përqindje më të vogël popullsie.

Qendrat e njësive administrative kanë largësi të ndryshme nga Rrësheni, qendra e Bashkisë, që variojnë nga 15 minuta (Rubiku) në 90 minuta (Selita apo Kaçinari). Ndërkohë pjesa dërmuese e fshatrave kanë distanca akoma më të mëdha nga qendra e Bashkisë.



2.2.2 Individë në nevojë për shërbime sipas të dhënave statistikore dhe josatistikore¹¹

Analiza e detajuar në vijim evidenton faktin se të paktën 5,959 individë në territorin e Bashkisë Mirditë ose 17% e popullsisë kanë të nevojshëm të paktën një formë shërbimi kujdesi shoqëror.

¹⁰ Gjendja civile të dhënat e popullsisë i raporton bashkë për Rrëshen e Kaçinar, si dhe për Kthellë e Selitë.

¹¹ Në Shtojcën 1 gjeni Treguesit e detajuar të analizuar


Tabela 1: Përqindja e individëve në nevojë për shërbime kundrejt popullsisë në njësi administrative

NJËSIA ADMINISTRATIVE	NR. POPULLSIE	NR. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME KUJDESI SHOQËROR	%
Rrëshen	16,019	1,939	14,6%
Kaçinar		401	
Rubik	7,880	879	11,2%
Fan	4,380	1,224	27,9%
Kthellë	4,836	631	21,6%
Selitë		412	
Orosh	2,979	473	15,9%
TOTALI BASHKI	36,094	5,959	16,5%

Theksojmë se numri i identifikuar i individëve në nevojë për shërbime kujdesi shoqëror është numri minimal, pasi të gjitha të dhënat e mbledhura i referohen rasteve të raportuara tek institucionet. Mungesa e identifikimit proaktiv në terren të rasteve nuk mundëson një njohje tërësisht reale të madhësisë së grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Grafik 3. Përqindja e individëve në nevojë për çdo njësi

Siç shihet nga grafiku 3, të gjitha njësitë kanë një përqindje të lartë të individëve në nevojë për shërbime referuar numrit të popullsisë, por në njësitë administrative Fan dhe Kthellë e Selitë kjo përqindje është më e lartë se sa përqindja e Bashkisë (16,5%).



Individë në nevojë sipas skemës së ndihmës ekonomike

932 familje janë aktualisht pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme e për rrjedhojë përfitojnë ndihmë ekonomike nga programi kombëtar i mbrojtjes sociale. Në tërësi në Bashkinë Mirditë ka një nivel të lartë të mbulimit me ndihmë ekonomike të familjeve të varfëra. Nga verifikimet në terren ka rezultuar që një numër i vogël familjesh të varfëra nuk kanë aplikuar apo nuk përfitojnë ndihmën ekonomike. Egzistenca e tyre nxjerr nevojën për të vijuar me informimin proaktiv në terren mbi mundësitë që egzistojnë për mbështetje përmes programit të ndihmës ekonomike.

Niveli i varfërisë në këtë Bashki mund të konsiderohet i lartë pasi 7,9% e familjeve në këtë Bashki janë të përfshira në programin e ndihmës ekonomike dhe nëse do ti referoheshim censurit përqindja e tyre kundrejt totalit është 13%. Edhe pse në Rrëshen e Kaçinar kemi numrin më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, analiza tregoi se në raport me popullsinë njësitet administrative me përqindjen më të lartë të përfituesve janë Fani, Kthella dhe Selita.

Analiza për karakteristikat e familjeve përfituese në ndihmës ekonomike tregoi se familjet me numër më të madh anëtarësh janë përgjithësisht familjet më të varfëra. 13% e fëmijëve në Bashkinë Mirditë janë pjesëtarë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Nga grupmoshat e analizuar ka një përfshirje shumë të ulët në skemë të grupmoshës mbi 64 vjeç, pasi vetëm 2% e pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike i përkasin kësaj grupmoshe. Ndërkohë ka shumë të moshuar në nevojë të papërfshirë në skemën e ndihmës ekonomike që jetojnë vetëm dhe në shtëpi me qera. 8% e familjeve përfituese kanë gra kryefamiljare, ndërsa 50% e komunitetit egjiptian jeton përmes ndihmës ekonomike. 3% e familjeve kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuara.

Punëkërkuesit

529 individë në Bashkinë Mirditë janë në kërkim të një pune sipas të dhënave të Zyrës së Punës për muajin prill 2020. 59% e punëkërkuesve janë femra dhe 41% janë meshkuj. Mungojnë analiza të thelluara mbi arsyet që i mbajnë gratë e vajzat më larg tregut të punës se sa meshkujt.

Përgatitja për tregun e punës, egzistenca e një profesioni është e lidhur me tipin e arsimit, veçanërisht atë profesional ose të lartë. Vetëm 6,6% e punëkërkuesve të papunë kanë arsim profesional dhe 6% arsim të lartë. 85% e tyre kanë arsim 9 vjeçar ose të mesëm të përgjithshëm. Kjo karakteristikë është më e lartë tek femrat (60% e këtij grupi) se sa tek meshkujt, që është një nga arsyet që shpjegon edhe pse ato janë në përqindje më të lartë se meshkujt në kërkim të një pune. Arsye më të thelluara duhen kërkuar përmes analizave specifike. Gjithashtu punëkërkuesit mbi 40 vjeç e kanë më të vështirë të gjejnë një punë.

Këto karakteristika të punëkërkesve të papunë nxjerrin në dukje nevojën për analiza të tregut të punës për të identifikuar tipet e profesioneve të kërkuara dhe realizimin e kurseve profesionale në përputhje me këto karakteristika. Zgjidhje të tilla duhet të targetojnë veçanërisht grupet më të përjashtuara në tregun e punës: gratë (veçanërisht kryefamiljaret), individët pa profesion (duke përfshirë ata me moshë mbi 40 vjeç), egjiptianët, emigrantët e kthyer.

Vetëm 1 person me aftësi të kufizuara është i regjistruar si punëkërkues i papunë. Duhet punuar për ndërgjegjësimin si të personave me aftësi të kufizuara për tu përfshirë në tregun e punës, ashtu edhe me punëdhënësit për të shmangur diskriminimin e mundshëm dhe krijuar kushtet e nevojshme ndaj nevojave të këtyre personave në vendin e punës.

Individë me aftësi të kufizuara

818 persona në Bashkinë Mirditë janë vlerësuar nga komisionet mjeksore me të paktën një formë të aftësisë së kufizuar. Referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë konkludojmë se 2,3% e popullsisë së kësaj Bashkie është përfshirë në programin e pagesave cash të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar.

26% e personave me aftësi të kufizuara kanë të paktën një formë të rëndë të aftësisë së kufizuar dhe mbështeten nga një ndihmës. Programi i pagesave cash nuk mund të adresojë i vetëm nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të jenë funksionale në përputhje me këto nevoja. Grupi më i madh i personave me aftësi të kufizuara është ai me problemet e të shëndetit fizik e mendor. Njësitë administrative Rrëshen, Rubik dhe Fan kanë numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara.

Fëmijët me aftësi të kufizuara përbëjnë 2,1% të fëmijëve në Bashkinë Mirditë dhe 21% të personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki. Nevojat e tyre për shërbime duhen vlerësuar dhe duhen konsideruar me prioritet, pasi ndërhyrja që në moshë të hershme, jo vetëm përmirëson cilësinë e jetës për ta dhe familjet e tyre, por edhe krijon kushtet për integrimin e tyre më të lehtë në shoqëri në të ardhmen. Në çdo njësi administrative ka fëmijë me aftësi të kufizuara, por në përqindje më të lartë ata jetojnë në Rrëshen, Rubik dhe Fan.

Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët

Në 1,037 fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje përqindjen më të lartë e zenë fëmijët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (81% e rasteve), si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (17% e rasteve). Sikurse argumentuam edhe më parë programi i pagesave cash për ta apo familjet e tyre është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre për zhvillim

dhe integrim njësoj si bashkëmoshatarët e tyre, prandaj duhet të egzistojnë shërbimet specifike të kujdesit shoqëror të ndërtuara sipas nevojave të secilit grup mes fëmijëve.

Rastet e fëmijëve të identifikuar me urdhëra mbrojtje, tregojnë se fëmijët gjithashtu janë viktimë e dhunës në familje, prandaj janë të nevojshme si fushatat e informimit për parandalimin e dhunës, ashtu edhe shërbimet specifike për ta.

Numri i ulët i rasteve të menaxhuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje (23 raste gjatë vitit 2019) mund të jetë i lidhur me burimet njerëzore të kufizuara (vetëm 1 Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve në një terren me nevoja shumë të larta për menaxhimin e rasteve), që kufizon mundësinë e identifikimit proaktiv të rasteve dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me aktorë publik e jopublik që kanë detyrime ligjore në këndvështrimin e garantimit të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Viktima të dhunës në familje

Numri konsistent i rasteve të dhunës (për vitin 2018 janë rregjistruar 12 raste të dhunës në familje, ndërsa për vitin 2019 janë rregjistruar 11 raste dhune) tregon që fenomeni i dhunës në familje egziston në Bashkinë Mirditë dhe ai duhet adresuar si me masa parandaluese, ashtu edhe me shërbime specifike të kujdesit shoqëror të ngritura sipas nevojave të identifikuara për këtë grup.

Në kushtet që për shkak të mentalitetit jo çdo rast dhune raportohet, theksojmë nevojën për të ndërgjegjësuar komunitetin për efektet e dhunës dhe domosdoshmërinë për ta raportuar atë. Pjesë e këtyre masave duhet të jenë fushatat e informimit që duhet të kryhen nga Bashkia në bashkëpunim me struktura të tjera lokale që targetojnë si nxënësit e shkollave, ashtu edhe të gjithë komunitetin vendor. Ekzistenca e një koordinatori për masat kundër dhunës në familje që kryen vetëm këtë funksion dhe ndërveprimi i vazhdueshëm me aktorë publik e jopublik që kanë detyrime ligjore në këndvështrimin e masave kundër dhunës në familje, janë të rëndësishme për të rritur efektivitetin e ndërhyrjeve ndaj këtij fenomeni.

Të pastrehë

Strehimi u raportua si një çështje prioritare për Bashkinë Mirditë. Nga 187 familjet që kanë aplikuar për strehim në këtë Bashki 10 prej tyre përfitojnë nga programi i banesave sociale (8 familje) dhe bonusit të qerasë (2 familje). Bashkia trajton me përparësi familjet pa të ardhura dhe që nuk kanë banesë në pronësi. Janë 41 familje egjiptiane që problem kryesor kanë strehimin.

Mungesa e strehimit duket se është më tipike në njësinë administrative Rrëshen (77% e familjeve aplikuese banojnë në këtë njësi). Nëse i referohemi numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Mirditë rezulton se 1,6% e tyre e kanë të pamundur të sigurojnë strehimin me të ardhurat e tyre dhe kërkojnë mbështetje nga kjo Bashki. Të moshuarit dhe familjet përfituese të ndihmës ekonomike janë grupet më të prekura nga ky problem dhe ata duhet të trajtohen me prioritet për shkak të vulnerabilitetit të lartë.

Të moshuar në nevojë për shërbime

Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social raporton për një përfshirje shumë të vogël të të moshuarve në skemën e ndihmës ekonomike (vetëm 60 të moshuar pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike). 48 të moshuar i kanë kërkuar Bashkisë mbështetje për strehim. Nëse i referohemi numrit të të moshuarve (4137) mund të themi që minimalisht 2,6% e tyre kanë nevojë për më shumë mbështetje. Ndërkohë sektori thekson se janë 487 të moshuar në territor që jetojnë vetëm, pasi fëmijët janë në emigracion, si dhe ata kanë të ardhura shumë të vogla.

Megjithatë nuk ka të dhëna statistikore të mbledhura në mënyrë të vazhdueshme mbi nevojat për shërbime për të moshuarit, gjë që e vështirëson të kuptuarin e nevojave për këtë target-grup. Sikurse edhe në rastin e dhunës në familje apo mbrojtjes së fëmijëve mungesa e punonjësve social që punonjnë për identifikimin, menaxhimin dhe referimin tek shërbimet sjell për pasojë edhe mungesën e informimit të komunitetit se ku dhe si të kërkoj mbështetje, edhe identifikimin e rasteve nga vetë strukturat e Bashkisë.

Divorcet

Për periudhën Janar-Mars 2020 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka regjistruar 34 divorce. Numri më i lartë i rasteve të divorcit është regjistruar në njësitë administrative Rrëshen, Kaçinar dhe Rubik.

2.3 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale

2.3.1 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë¹²

¹² Në shtojcën 2 gjeni nevojat për shërbime në këndvështrimin e individëve në nevojë, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me shërbimet

1. Shërbime mbështetëse apo fuqizuese për familjet përfituese të ndihmës ekonomike

Përveç programit kombëtar të pagesave cash të ndihmës ekonomike Bashkia Mirditë deri në vitin 2019 ka akorduar nga të ardhurat e saj 160 mijë lekë për të trajtuar me ndihmë familje që nuk përfitonin nga programi kombëtar. Në periudhën e pandemisë së covid -19 Bashkia gjithashtu financoi pako ushqimore për familje të varfëra në territorin e saj. Në Rrëshen dhe në Fan “Caritas” ka ngritur menca. Në Rrëshen 50 familje në nevojë konsumojnë drekën dhe darkën.

Egzistojnë nisma jopublike për fuqizimin ekonomik të familjeve në territorin e Bashkisë. Aktualisht “World Vision” po zbaton një projekt për riintegrimin e azilantëve të kthyer. Pjesë e projektit janë 31 familje të kthyer nga emigracioni, të cilat ndër të tjera po mbështeten për ngritjen e start up, si një mekanizëm që mundëson fuqizimin e tyre ekonomik.

“Caritas” gjithashtu si pjesë të përmbushjes së prioritetit për fuqizimin ekonomik të familjeve në territorin e Bashkisë Mirditë ka punuar në fshatra për të mbështetur familjet në Kaçinar dhe Fan me bagëti të imëta. Në Fan ka ngritur një ndërmarrje sociale, në të cilën pas trainimit janë punësuar 7 gra të cilat tashmë prodhojnë makarona dhe të ardhurat mundësojnë jetesën për to dhe familjet e tyre. Gjithashtu pjesë e mbështetjes së “Caritas” janë edhe 10 të rinj që ndjekin shkollën profesionale jopublike në këtë Bashki.

Programe të tilla janë një bazë e rëndësishme, nga mund të nisi një program më i zgjeruar dhe me përfshirjen e më shumë burimeve e aktorëve, që në thelb do të mundësonte fuqizimin ekonomik të individëve madhorë të familjeve më në nevojë në këtë Bashki.

2. Shërbime për punëkërkesit e papunë

Kurse formimi profesional dhe oferta për punësim janë shërbimet që ofron Zyra e Punës për individët madhorë në kërkim të punës të familjeve me ndihmë ekonomike. Për kurset e formimit profesional bashkëpunohet edhe me qendrat e formimit profesional në Tiranë. Problemi kryesor i theksuar në tryezën e konsultimit në lidhje me punësimin është mungesa e vendeve të punës. Mundësitë janë shumë të kufizuara për punë në territorin e Bashkisë.

Intervistat e zhvilluara me individë madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike treguan në disa raste se vizitat e tyre në zyrën e punës janë pothuajse formale, madje u identifikuan edhe raste që edhe pse të papunë prej vitesh ka individë që nuk paraqiten pranë zyrës së punës.

Në Bashkinë Mirditë është ngritur dhe funksionon Qendra “Shën Jozefi” e cila ofron kurse formimi profesionale, por funksionon edhe si shkollë profesionale jopublike. Kurset ngrihen

sipas kërkesave dhe përgjithësisht janë: kurse hoteleri turizëm, guzhinë, mekanike, infermieri, kurse të gjuhëve të huaja.

3. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara

Aktualisht në territorin e Bashkisë nuk ka asnjë formë shërbimi kujdesi shoqëror që të adresonte nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Për shumë vite funksiononte një qendër ditore për persona me aftësi të kufizuara në Rrëshen, por për mungesë financimi kjo qendër është mbyllur.

Shërbimi shëndetësor është i shtrirë në të gjithë territorin. Specifikisht në Bashkinë Mirditë ka 7 Qendra Shëndetësore (në çdo njësi administrative ka një qendër shëndetësore) dhe 60 ambulanca. Në total numri i personelit mjekësor në sistemin shëndetësor në Bashki është 13 punonjës. Në qendër të Bashkisë ka një spital me kapacitet 96 shtretër ku shërbejnë 11 mjekë. “Caritas” në Rrëshen mundëson shërbimin paliativ dhe atë terminal.

Në tryezën e konsultimit dhe nga intervistat e zhvilluara me përfitues të skemës së mbrojtjes sociale u theksua se sfidat kryesore në lidhje me shërbimin shëndetësor lidhen me distancat e largëta, si dhe me mungesën e specialistëve. Në mungesë të specialistëve individët me aftësi të kufizuara duhet ti drejtohen Lezhës ose Tiranës.

Godinat dhe mjediset publike nuk janë kudo të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Nuk ndeshen raste të braktisjes së personave me aftësi të kufizuara nga familjarët e tyre.

Nga strukturat arsimore theksohet se për fëmijë me nevoja të veçanta në shkollë ka mësues ndihmës, të cilët janë të profilizuar. Raportohet problematik shpesh bashkëpunimi me prindin e fëmijës me nevoja të veçanta. Egziston një mentalitet i izolimit dhe mospranimi të aftësisë së kufizuar të fëmijës nga një pjesë e prindërve. Ata nuk pranojnë diganostifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit mjekësor të fëmijës. Kjo çështje e mentalitetit duhet adresuar me informim dhe ndërgjegjësim.

4. Sistemi komunitar i mbrojtjes dhe përkujdesit për fëmijë

Pjesë e sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social është i vetmi punonjës i mbrojtjes së Fëmijës për Bashkinë Mirditë, që jo vetëm mbulon të gjithë territorin, por edhe kryen funksione të koordinatorit për masat kundër dhunës në familje.

Grupet teknike ndërsektorale përfshijnë përfaqësues nga policia, shëndetësia dhe arsimi. Nuk mbledhen drejtuesit e Institucioneve që në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës kanë role dhe përgjegjësi si për ndërgjegjësimin për të drejtat e fëmijës, si dhe për

mbrojtjen e tyre. Sfida në punën për menaxhimin e rasteve lidhet kryesisht me distancat e mëdha të fshatrave nga qendra e Bashkisë, mungesat e buxhetit për menaxhimin e rasteve, sikurse dhe e logjistikës për t’ju përgjigjur në çdo kohë çdo rasti pavarësisht nga distanca.

Sfidë mbetet gjithashtu mungesa e shërbimeve të kujdesit shoqëror për fëmijët në territorin e Bashkisë Mirditë. Shërbimi i kujdesit alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror nuk është i ngritur, por rastet emergjente apo zgjidhjet më afatgjata janë menaxhuar në bashkëpunim me “Caritas” dhe drejtorinë rajonale të SHSSH Lezhë. Përgjithësisht raportohet që rastet e braktisjes së fëmijëve janë sporadike dhe jo më shumë se 1-2 raste në vit.

Në shkollë edhe pse shërbimi psikosocial funksionon në përputhje me udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse, numri i psikologëve është shumë i ulët dhe në këto kushte është e pamundur të adresohen nevojat për këtë shërbim.

5. Shërbime për viktimat e dhunës në familje

Viktimat e dhunës në familje të pajisur me urdhër mbrojtje përfitojnë pagesën nga programi kombëtar i mbrojtjes sociale, por në territorin e Bashkisë nuk egziston asnjë shërbim kujdesi shoqëror për to. Rastet menaxhohen nga e vetmja punonjëse e sektorit që trajton edhe rastet e mbrojtjes së fëmijës në ndërveprim me grupin teknik ndërsektorial. Grupet teknike përfshijnë përfaqësues nga policia, shëndetësia dhe arsimi. Nuk mblidhen drejtuesit e Institucioneve që në përputhje me ligjin për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare kanë role dhe përgjegjësi si për parandalimin e dhunës, ashtu dhe adresimin e nevojave të viktimave të dhunës në familje.

Sfida në punën për menaxhimin e rasteve lidhet kryesisht me vështirësinë për të identifikuar rastet e dhunës, distancat e mëdha të fshatrave nga qendra e Bashkisë, mungesat e buxhetit për menaxhimin e rasteve, sikurse dhe e logjistikës për t’ju përgjigjur në çdo kohë çdo rasti pavarësisht nga distanca.

6. Shërbimi i strehimit social

Edhe pse ka kërkesa për strehim nga familje në çdo njësi administrative të Bashkisë, familjet e trajtuara deri tani janë banorë të njesisë administrative Rrëshen. Vetëm 3 nga familjet që përfitojnë nga programet e strehimit janë edhe përfituese të ndihmës ekonomike.

Në lidhje me bonusin e qerasë mbetet problem fakti që pronarët e shtëpive nuk pranojnë të lidhin kontratë me familjet përfituese të këtij bonusi. Pamundësia e kontratës rrjedhimisht bën të pamundur mbështetjen që Bashkia mund të jepte familjeve kërkuuese për bonus qeraje.

Një tjetër sfidë mbetet buxheti shumë i vogël për të trajtuar numrin e lartë të kërkesave për strehim në këtë Bashki. Bashkia ka bërë kërkesë pranë ministrisë së linjës për banesa sociale dhe është në pritje të financimit.

7. Shërbime për të moshuarit

Ka një nevojë reale në territorin e Bashkisë për shërbime specifike për të moshuarit. Analiza e grupeve vulnerabël identifikoi se të paktën 2,6% e tyre ka të nevojshëm shërbime mbështetëse sociale. Kundrejt kësaj nevojë këto shërbime aktualisht mungojnë. Bashkia është e vëmendshme ndaj situatës së tyre dhe për më të varfërit ndërhyr duke ofruar paketa ushqimore falas, por mungojnë shërbime të tjera specifike sociale të tilla si shërbim në familje apo qendër ditore.

8. Shërbimet për familjet që kanë përjetuar divorc

Për divorcet e rregjistruara në Bashkinë Mirditë nuk ka asnjë shërbim që mund të mbështeste pjesëtarët e këtyre familjeve.

2.3.2 Shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Qarkut Lezhë

Në Qarkun Lezhë janë dy shërbime tek të cilat mund të kenë akses edhe fëmijë në nevojë të Bashkisë Mirditë. Specifikisht:

Qendra “E Lumja Marie Tuci” në Troshan: Përveçse shërbimit si çerdhe e kopësht, kjo qendër ofron shërbim rezidencial për fëmijë të grupmoshës 6-11 vjeç pa kujdes prindëror. Qendra mund të shërbejë për rastet emergjente për fëmijë të kësaj grupmoshe.

Qendra “Rozalba” në Gjadër: Shërbim rezidencial për vajza të grupmoshës 14-18 vjeç në rrezik trafikimi. Qendra ofron shërbime përkujdesi, si dhe aktivitete psiko-sociale.

2.4 Mangësitë në shërbime

Analiza e individëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror mundësoi identifikimin e 5,959 individëve që aktualisht kanë nevojë për të paktën një nga tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Duke ju referuar shportës së shërbimeve të kujdesit shoqëror¹³ në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”¹⁴, nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror jepen në tabelën 2.

Tabela 2: Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

INDIVIDE NE NEVOJE PER SHERBIME	TERRITORI	TIPET E SHERBIMEVE SIPAS SHPORTES
	BASHKIA MIRDITË	
Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike	2,584	1. Program për fuqizimin ekonomik. Me prioritet individët e familjeve përfituese të NE.
Punëkërkuar	529	2. Informimi dhe këshillimi për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.

¹³ Në Shtojcën 3 jepet në mënyrë të plotë Shporta e Shërbimeve

¹⁴ [Aksesuar nga http://ëëë.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf](http://ëëë.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf)

Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç	644	1. Shërbime rehabilituese për personat në nevojë për aftësim fizik; 2. Shërbimet në familje për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; 3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë.
Invalidë Pune	853	
Fëmijë në nevojë për mbrojtje	23	1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës 2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, për zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.
Fëmijë në familje përfituese të ndihmës ekonomike	840	3. Qendrat ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike; 4. Qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara;
Fëmijë me aftësi të kufizuara	174	5. Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese për fëmijë me çrregullime pervazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; 6. Shërbimi i emergjencës 72 orë për fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

Individ viktima dhune në familje	23	1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; 2. Shërbimi i emergjencës 72 orë, per viktima të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. 3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur per viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë. Organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.
Individ në familje të pastreha	694	1. Bonusi i qerasë, 2. banesa sociale me pagesë të reduktuar, 3. kreditë e buta.
Të moshuar në nevojë për shërbime	108	1. Shërbimet në familje për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. 2. Qendra ditore për të moshuarit;
Divorce	102	1. Shërbim psikosocial

2.5 Analiza SWOT

Pikat e forta

1. Liderhipi

Ekipi drejtues, personeli i strukturës përgjegjëse aktuale për shërbimet sociale në këtë Bashki dhe në njësitë administrative kanë vullnet, motivim dhe qartësi të plotë për nevojën për të ngritur dhe bërë funksional sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki.

2. Partneriteti

Struktura përgjegjëse e shërbimit social në Bashkinë Mirditë ndër vite ka zhvilluar partneritetin me institucione publike lokale e rajonale, si dhe organizata joqeveritare që kanë ngritur e zbatuar projekte apo shërbime që adresojnë nevojat e grupeve vulnerabël në territorin e saj. Ndërveprimi mes aktorësh publik e jopublik është thelbësor për një sistem efektiv komunitar shërbimesh kujdesi shoqëror.

3. Modelet egzistuese

Modelet e zhvilluara veçanërisht për fuqizimin ekonomik nga organizatat joqeveritare, sikurse dhe egzistenca e disa formash shërbimesh në territorin e qarkut janë të rëndësishme për të lehtësuar punën e strukturave përgjegjëse të Bashkisë në ngritjen praktike të shërbimeve të parashikuara në këtë Plan Social.

Pikat e dobëta

1. Personel i kufizuar për menaxhimin e rasteve sociale

Në tërësi analiza tregoi se strukturat, përshkrimet e punës, si dhe numri i personelit në të dy nivelet e organizimit të Bashkisë nuk i përgjigjen tërësisht detyrimeve që rrjedhin nga të paktën tre ligje: Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale duhet të përfshijë në strukturë Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës, të ndarë si detyrë nga ajo e koordinatorit vendor për masa kundër dhunës në familje. Përshkrimet e punës së tyre duhet ti përgjigjen kërkesave të dy ligjeve respektive. Në

kushtet që sektori përmbush edhe detyra për administrimin e programit të pagesave cash për njësinë administrative Rrëshen, struktura e tij duhet të plotësohet me punonjës social detyra e të cilit (në drejtimin e përgjegjësit të sektorit) duhet të jetë planifikimi, ngritja dhe funksionimi i sistemit komunitar të shërbimeve shoqërore në ndërveprim me të gjitha njësitë administrative.

Në përputhje me numrin e banorëve dhe numrin e fëmijëve strukturat e njësive administrative Rrëshen, Kaçinar dhe Rubik duhet të plotësohen me pozicionin e punonjësit social. Gjithashtu në Rrëshen duhet të plotësohet struktura me pozicionin e PMF për këtë njësi administrative. Në njësitë administrative Fan, Kthellë, Selitë, Orosh administratorët shoqëror duhet të përmbushin edhe funksionet e punonjësit social dhe të PMF.

Është i nevojshëm gjithashtu ndryshimi i përshkrimeve të punës së punonjësve në të gjitha nivelet në përputhje me strukturat e propozuara.

2. Vështirësi në menaxhimin e rasteve

- Stafi punon në një ambjent të përbashkët, të papërshtatshëm për nevojat e punës me grupe vulnerabël në tërësi dhe në veçanti punës me fëmijët dhe viktimat e dhunës në familje.
- Lëvizja nëpër fshatra për menaxhimin e rasteve shumë e vështirë. Distancat janë të largëta dhe vështirësia rritet sidomos në orët e vona kur mungon çdo formë transporti.
- Nuk ka buxhet të dedikuar për menaxhimin e rasteve, kostot përballohen nga vetë punonjësit.
- Numri i punonjësve është i limituar.
- Mungesa e shërbimeve e bën të vështirë menaxhimin e rasteve.

3. Mos financim i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Në Bashkinë Mirditë nuk është financuar asnjë shërbim kujdesi shoqëror, sikurse nuk janë parashikuar për vitet në vijim fonde për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki.

Mundësitë

1. Kuadri ligjor

Egziston tashmë një kuadër ligjor i plotë që rregullon ngritjen dhe funksionimin e sistemeve komunitare të kujdesit shoqëror. Aktet nënligjore të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” kanë përcaktuar qartësisht sistemin e rregullave për ngritjen e shërbimeve komunitare për grupet në nevojë për shërbime, për mekanizmin e financimit të shërbimeve, sikurse edhe për burimet njerëzore që duhet të egzistojnë në funksion të këtij sistemi. Për shërbimet e kujdesit shoqëror egzistojnë standarte kombëtare të miratura që janë baza mbi të cilën do të ngrihen tipet e shërbimeve që përmban Plani Social.

2. Mbështetje e donatorëve

Bashkia ka kapacitete për të identifikuar donatorë të mundshëm, si dhe kërkuar financim prej tyre me qëllim ngritjen e fondit social dhe financimin e shërbimeve. Egzistenca e këtij Plani Social lehtëson përpjekjet e Bashkisë në këtë drejtim.

3. Eksperienca dhe praktika të ngjashme

Në nivelin e Qarkut egzistojnë forma shërbimesh të cilat mund të ndihmojnë stafin social të Bashkisë në modelimin e këtyre shërbimeve në këtë territor. Vizita studimore mund të ndërmerren nga stafi përgjegjës i shërbimit social të Bashkisë në shërbimet e ngritura me qëllim marrjen e eksperiencës dhe modelit praktik në ngritjen e tyre.

Rreziqet

1. Mungesa e mbështetjes financiare

Bashkia nuk ka parashikuar në buxhetin tre vjeçar të saj fonde për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Bashkisë do ti duhet të alokoj fonde nga të ardhurat e saj, të kërkoj mbështetje financiare nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, sikurse të ndërtojë punën me donatorë të ndryshëm me qëllim financimin e komponentëve të këtij Plani. Ndërveprimi efektiv mes strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dhe koordinatorit të projekteve me Bashkimin Europian për të përgatitur projekte të detajuara, sikurse angazhimi i këtij të fundit për të identifikuar donatorë të mundshëm dhe për të aplikuar cilësisht pranë tyre për të siguruar financim, është tejet i rëndësishëm.

2. Mungesa e eksperiencës

Në kushtet që në territorin e Bashkisë nuk egziston aktualisht asnjë shërbim i kujdesit shoqëror, për strukturat e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki mungesa e eksperiencës me shërbimet është një sfidë që duhet kapërcyer përmes trainimeve, por edhe vizitave studimore në shërbime egzistuese jashtë Bashkisë Mirditë.

3. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Plani Social i Bashkisë Mirditë për periudhën 2024-2026 do të synojë adresimin e nevojave për mbrojtje e shërbime kujdesi shoqëror për të paktën 5,959 individë në situatë të vështirë ekonomike apo përjashtimi social, të mundësuar nga një sistem komunitar i mirëkoordinuar shërbimesh të gatëshme, të arritëshme dhe të përshtatëshme për nevojat e tyre.

Për të përmbushur këtë qëllim janë parashikuar ndërhyrje të koordinuara me njëra-tjetrën në katër drejtime kryesore:



1. Thellim i rolit dhe funksionit të strukturave përgjegjëse të mbrojtjes dhe kujdesit social.

Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror ngrihet dhe funksionon përmes stafit të strukturës së Bashkisë të ngritur në përputhje me detyrimet ligjore në të dy nivelet e organizimit të saj. Pa ekipet e duhura numerikisht, të përgatitur profesionalisht dhe të mbështetur me infrastrukturën dhe buxhetin e duhur nuk do të mund të planifikojmë e menaxhojmë shërbimet komunitare dhe as të identifikojmë, të menaxhojmë e referojmë individët në nevojë tek këto shërbime.

2. Rritje e rasteve të identifikuara të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Edhe pse ky Plan ngrihet mbi një numër të konsiderueshëm individësh në nevojë për shërbime të identifikuar përmes treguesve statistikor, analiza e nevojave për shërbime tregoi se është e domosdoshme që strukturat e Bashkisë dhe aktorët e tjerë lokalë publikë e jopublikë duhet të ndjekin një qasje më proaktive në identifikimin e rasteve në nevojë për shërbime. Kjo është e domosdoshme në mënyrë të veçantë për rastet e dhunës në familje, fëmijët në nevojë për mbrojtje, të moshuarit që jetojnë vetëm apo individë të tjerë në territor.

3. Ofrim i shërbimeve sipas nevojave përmes sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Analiza e shërbimeve egzistuese në territorin e Bashkisë dhe nivelin e qarkut, si dhe e nevojave për shërbime të grupeve të identifikuara identifikoi qartësisht shërbimet e munguara dhe që duhen ngritur me prioritet për periudhën tre vjeçare të zbatimit të këtij Plani.

4. Riintegrim ekonomik dhe social për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. 43% e individëve në nevojë për shërbime të identifikuar kanë si nevojë kryesore përgatitjen për tregun e punës dhe punësimin. Në këto kushte është e domosdoshme ndërhyrja e koordinuar e programeve për fuqizimin ekonomik të tyre me shërbimet sociale rast pas rasti.

Qëllimi 1.

Thellim i rolit dhe funksionit të strukturave përgjegjëse të mbrojtjes dhe kujdesit social.

Objektivi 1. Brenda vitit 2024 do të riorganizohet struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dhe do të ngrihen e funksionojnë Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Aktiviteti 1.1 Rishikim i strukturës, roleve dhe funksioneve të Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki

Sektori do të përmbushë këto funksione:

1. Koordinimi dhe drejtimi i zbatimit të programeve të pagesave cash NE dhe PAK për të gjithë territorin e Bashkisë.
2. Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin komunitar.
3. Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët.
4. Barazia gjinore dhe masa kundër dhunës në familje
5. Zbatimi i programit cash NE dhe PAK dhe menaxhimi i rasteve sociale për njësinë administrative Rrëshen

Tabela 3: Struktura dhe detyrat për çdo pozicion pune

Pozicioni	Numri i personelit	Detyrat kryesore ¹⁵
Përgjegjës sektori	1	Koordinon, drejton të gjithë aktivitetin e sektorit në të gjithë komponentët në përputhje me funksionet e sektorit.
Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës	1	Mbështet PMF në NJMF e njësive administrative për manaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Supervizon mirëqenien dhe përparimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në NJMF të njësive administrative, të cilët kanë marrë Masat e Mbrojtjes dhe ndiqen me anë të një Plani Individual Mbrojtjeje; I raporton në mënyrë periodike Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve (ASHMDF), me të dhëna statistikore të procesuara mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe NJMF përkatëse; Identifikon të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jo publike për mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë, përfshi përfaqësuesit e shërbimeve të përkujdesit alternativ, shërbimeve shëndetësore, psikologjike, sociale, ligjore, punonjësit e specializuar të policisë, përfaqësuesit e prokurorisë dhe institucionet arsimore; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial në nivelin e bashkisë dhe/ose njësisë administrative dhe koordinon funksionimin e tij, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, referimin dhe ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve, lidhur me Masat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Mbrojtjes; Rrit ndërgjegjësimin e komunitetit mbi mbrojtjen e fëmijëve, organizon aktivitete informuese, edukuese dhe trajnuese mbi mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë; Shërben si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen mbi apo të referohen tek shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave të tyre; Harton dhe rishikon në

¹⁵ Për përshkrimin e punës së çdo "Udhërrëfyes për Bashkitë, për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror", publikim i UNICEF dhe Esa Consulting

		mënyrë të përvitshme listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në proceset penale, dhe ia dërgon strukturave vendore të policisë së shtetit, si dhe prokurorive dhe gjykatave përkatëse.
Koordinatori për masa kundër dhunës në familje dhe punonjës për çështjet e barazisë gjinore	1	Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës ka funksionin e menaxherit të rastit për rastet e dhunës në familje. Ai koordinon Grupin Teknik Ndërsektorial dhe siguron burime ose i referon pranë shërbimeve. Ai siguron që të gjitha rastet e dhunës në familje të ndjekin të gjitha procedurat dhe siguron informacion gjithëpërfshirës dhe të përditësuar mbi situatën. Ai koordinon punën e të gjithë aktorëve dhe ofruesve të shërbimeve publike dhe jo publike për të garantuar nëpërmjet masave ligjore mbrojtje të anëtarëve të familjes që janë viktimë të dhunës në familje, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Punonjësi për Çështjet e Barazisë Gjinore harton politika, programe, dokumenta dhe akte nënligjore sipas këndvështrimit gjinor dhe kuadrit të luftës kundër dhunës në familje. Ai është përgjegjës për integrimin e çështjeve të barazisë gjinore në politika, programe, dokumenta dhe ligje të cilat hartohen nga bashkia. Ai monitoron zbatimin e angazhimeve të qeverisjes vendore për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, në përputhje me dokumentat strategjike dhe ligjet kombëtare, si dhe në konventat ndërkombëtare.
Punonjës social	1	Drejton punën për identifikimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin në juridiksionin e bashkisë; Hartimi i projekt Planit Social vendor duke kostuar shërbimet e nevojshme të identifikuar, si dhe përgatitjen e Programit Buxhetor vjetor përkatës, për miratim në këshillin bashkiak; planifikimi i kalendarit të shpërndarjes vjetore dhe sigurimin e ofrimit të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjatë një viti; Krijimi i sistemit të mbikëqyrjes së shërbimeve në territorin e bashkisë; Propozimi i përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për miratim nga Këshilli Bashkiak; Mbështet me kapacitete strukturat e menaxhimit të rastit në njësitë administrative; Ndërvepron me specialistin e strehimit në Drejtorinë e Urbanistikës për adresimin përmes strehimit të nevojave të grupeve vulnerabël sipas prioriteteve gjatë menaxhimit të rasteve të referuara nga NjVNR; Koordinon zbatimin e programeve për fuqizimin ekonomik;
Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për njësinë administrative Rrëshen	2 administratore shoqëror 1 punonjës social 1 Punonjës i	<i>Administratori shoqëror:</i> Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Propozon dhe kontribuon në përmirësimin e politikave, programeve, dokumentave dhe kornizës ligjore në nivel kombëtar dhe rajonal në mbështetje të individëve në nevojë dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave kombëtare

	mbrojtjes së fëmijës	në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga MMRS si autoriteti përgjegjës. <i>Punonjësi social kryen:</i> identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; vlerësimin fillestar të nevojave dhe të nivelit të riskut për individët në nevojë; informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; mbikëqyrjen në vazhdim të ecursisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar; hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar. <i>Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës:</i> Përgatit vlerësimin e rrezikut të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Perditeson bazën e të dhënave të mbrojtjes së fëmijëve me informacion mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje, Masat e Mbrojtjes dhe Planin Individual të Mbrojtjes; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial në nivelin e njësisë administrative dhe merr masa për zbatimin e vlerësimit të rastit të cdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe përgatitjen e një Plani Individual Mbrojtjeje, i cili përfshin propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes; Informon NJMF dhe Drejtorin e strukturës përgjegjëse në bashki mbi Planin Individual të Mbrojtjes dhe propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes dhe koordinon ndërhyrjet dhe veprimet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Monitoron zbatimin e Masës së mbrojtjes dhe përparimin e zhvillimit të fëmijës nën këtë masë mbrojtjeje; I kërkon anëtarëve të Grupit Teknik Ndërsektorial informacion mbi përparimin, sfidat dhe problemet e hasura gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes; Propozon ndryshimin apo heqjen e Masës së Mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo mbylljen e Planit Individual të Mbrojtjes, nëse kushtet për shkak të të cilave ishte marrë masa dhe ishte ndërtuar plani, nuk ekzistojnë më, apo kur një propozim i tillë i shërben fëmijës dhe është në interesin e tij/e saj më të mirë; Lehtëson dhe mbështet fëmijën dhe/ose familjen e tij/saj në kryerjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Merr pjesë në procese gjyqësore ku diskutohen Masat e Mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes për rastet e fëmijëve që ai/ajo po menaxhon; I kërkon prokurorit heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e informuar atë mbi prindërit që shfaqin mungesë të fortë përkujdesi në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.
--	----------------------	---

Aktiviteti 1.2 Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në nivelin e Njësive administrative

Në tabelën në vijim jepet përbërja e këtyre Njësive në përputhje me kriteret ligjore. Nuk është përfshirë njësia administrative Rrëshen, pasi ajo është përfshirë tashmë në strukturën e Bashkisë.

Tabela 4: Përbërja e NJVNR në 6 njësi administrative

NJESIA ADMINISTRATIVE	TE DHENAT REFERENCE				NJESIA E VLERESIMIT TE NEVOJAVE DHE REFERIMIT		
	Nr. Banorë	Nr. Fëmijë	Nr.familje NE	Nr. Individ PAK	Punonjës Social	PMF	Administrator shoqëror
Kaçinar	16,019	3,413 ¹⁶	80	43			1
Rubik	7,880	1,608	126	162	1		1
Fan	4,380	1,163	223	111			2
Kthellë	4,836	1,173	123	71			1
Selitë			78	56			1
Orosh	2,979	625	73	66			1
TOTALI	36,094	7,982	932	818	1	0	7

Vetëm në Rubik do të kemi shtimin e pozicionit të punonjësit social, i cili në thelb do të kryej detyra të: punonjësit social, PMF dhe koordinatorit për masa kundër dhunës në familje. Do të ndërveprojë me administratorin shoqëror për fuqizimin e individëve përfitues të programit të pagesave cash. Në të gjitha njësitë e tjera administrative administratorët shoqëror përveç detyrave që lidhen me aplikimin për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar do të përmbushin edhe detyra të punonjësit social, PMF dhe koordinatorit për masa kundër dhunës në familje¹⁷.

Objektivi 2: Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

¹⁶ Numri i banorëve dhe i fëmijëve i përkasin dy njësive: Rrëshen dhe Kaçinar

¹⁷ Për detyrat kyç të çdo pozicioni referoju tabelës 3, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për njësinë administrative Rrëshen.

Aktiviteti 2. 1 Trainime të stafit të Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Trainimet do të ndërtohen në përputhje me nevojat e personelit të të dy niveleve të organizimit (Sektori dhe NJVNR), si dhe të funksioneve që duhet të përmbushin këto struktura.

Trainimet për personelin e Sektorit të Ndhmës ekonomike dhe Shërbimit Social do të fokusohen të paktën në këto çështje:

- Planifikimi strategjik dhe buxhetimi i sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Mekanizmi i financimit të shërbimeve dhe teknika të hartimit të projekteve sociale.
- Standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, prokurimi dhe monitorimi i shërbimeve.

Trainimet për personelin e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të përfshijnë të paktën:

- Njohuri të thelluara mbi paketën legislative të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël;
- Teknika të punës në ekip dhe menaxhimit të rasteve sociale.
- Trainime specifike për çështje të mbrojtjes së fëmijës, viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit, si dhe këshillimi për punësim.

Aktiviteti 2. 2 Vizita studimore

Stafi i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social do të zhvillojë vizita studimore në Bashkitë Lezhë dhe Tiranë për tu njohur praktikisht me funksionimin e atyre tipeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror që egzistojnë në këto Bashki e që do të ngrihen në Bashkinë Mirditë sipas parashikimeve të këtij Plani.

Aktiviteti 2.3 Krijimi i infrastrukturës së punës së Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social si dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Puna me grupet vulnerabël, veçanërisht menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo e viktimave të dhunës në familje, kërkon mjedise pune të përshtatëshme. Njësia e Vlerësimit të Nevojave për njësinë administrative Rrëshen, edhe pse mbetet pjesë e strukturës së Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, do të ketë ambjente pune të veçanta nga pjesa tjetër e


stafit të këtij sektori. Ambjentet do të jenë të përshtatëshme për të mundësuar konfidencialitetin gjatë intervistimit si të personave që përfitojnë nga programi i pagesave cash, ashtu edhe të çdo individ që ka të nevojshëm shërbime specifike kujdesi shoqëror. Ambjente që mundësojnë konfidencialitetin e intervistimit do të krijohen në çdo njësi administrative.

Stafi i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social brenda gjashtëmuorit të parë të zbatimit të këtij plani do të përgatisë dhe do të udhëzojë stafet e Njërive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit mbi protokollet e punës për menaxhimin e rasteve. Në mënyrë të veçantë: aksesit dhe hedhja e të dhënave në Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale, paketën me të gjithë formularët për identifikimin dhe raportimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime, fëmijëve në nevojë për mbrojtje, viktimave të dhunës, si dhe çdo tip formulari të përcaktuar në legjislacion dhe akte nënligjore.

Aktiviteti 2.4 Zhvillimi i praktikës së punës për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e situatës së grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë.

Spektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social brenda vitit të parë të zbatimit të Planit do të identifikojë treguesit social, periodicitetin e mbledhjes së tyre dhe institucionet brenda dhe jashtë Bashkisë nga do ti sigurojë këto të dhëna. Analiza periodike e ndërtuar mbi treguesit social, komunikimi me grupet në nevojë për shërbime dhe aktorët publikë e jopublikë që kanë role e përgjegjësi në adresimin e nevojave të këtyre grupeve do të jetë udhërrëfyese si në formulimin e politikave lokale specifike për grupet në nevojë, ashtu edhe rishikimin e përvitshëm të Planit Social të Bashkisë. Në kushtet që nuk mund të ketë politika sociale lokale pa mbajtur në konsideratë zërin e çdo grupi në nevojë për mbrojtje e përkujdesje, Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të zhvilloj çdo vit dëgjesa me secilin prej këtyre grupeve. Dëgjesa do të zhvillohen veçanërisht me: fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit. Pas ngritjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuar në këtë Plan, kjo strukturë si pjesë e procesit të monitorimit të cilësisë së shërbimeve do të zhvilloj intervista/fokus grupe me përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre shërbimeve.

NDËRVEPRIMI PËR IDENTIFIKIMIN, MENAXHIMIN DHE REFERIMIN E RASTEVE SOCIALE



Qëllimi 2

Rritje e rasteve të identifikuara të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Objektivi 1: Brenda vitit 2024 do të ngrihet dhe do të jetë funksional sistemi i referimit dhe menaxhimit të rastit

Aktiviteti 1.1 Ngritja e sistemit të koordinuar të referimit të rasteve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social qartëson se ku dhe si do të referohen rastet e çdo individ në nevojë për shërbime. Ky sistem duhet të përfshijë të paktën:

- Një numër telefoni ku kushdo mund të referojë raste në çdo kohë.
- Një rrjet institucionesh/punonjësish dhe ofruesisht shërbimesh që kanë kontakte me komunitetin dhe që mund të referojnë raste tek struktura përkatëse në Bashki. Pjesë e këtij rrjeti duhet të jenë edhe kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit e komunitetit, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin.

Punonjësi social i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, NJMF dhe Koordinatorit vendor për masa kundër dhunës në familje identifikojnë institucionet lokale, ofruesit e shërbimeve të cilat në përputhje me legjislacionin në fuqi kanë role dhe funksione në tre komponentët: shërbimet sociale, mbrojtjen e fëmijëve, masa ndaj dhunës në familje. Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit të parë zhvillohet një tryezë ndër-institucionale për të zyrtarizuar ngritjen e sistemit të identifikimit të rasteve. Synimi është që pjesëmarrësve të institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve/organizatave tu prezantohet Plani për të punuar me komunitetet për informimin mbi egzistencën e shërbimeve dhe të drejtat e tyre. Pjesëmarrësve do tu kërkohet përfshirja në këtë plan për të maksimalizuar komunikimin me komunitetet vendore, si dhe ata do të informohen se ku dhe si mund të raportojnë raste të individëve në nevojë për shërbime pranë strukturave të Bashkisë.

Aktiviteti 1.2 Qartësimi i rolit të sistemit të koordinuar për mbështetjen e komuniteteve me shërbime

Pas ngritjes së sistemit të koordinuar Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social realizon një tryezë një ditore me pjesëmarrjen e kryetarëve të fshatrave dhe ndërlidhësit e

komunitetit, punonjës policie që punojnë në terren, drejtorë të shkollave, mjekë etj për të lehtësuar kuptimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe rolit që ata mund të luajnë për të identifikuar rastet në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Tre prezantime kyç mbahen nga :

- Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës- si të identifikojmë raste të fëmijëve të dhunuar/abuzuar apo në nevojë për shërbime dhe ku të referojmë.
- Koordinator i vendor për masa kundër dhunës në familje- si të identifikojmë dhunën në familje dhe ku të referojmë.
- Punonjësi social- grupet e tjera në nevojë për mbështetje (fokusi personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, familjet ekstremisht të varfëra) dhe ku ti referojmë për mbështetje të menjëherëshme.

Aktiviteti 1. 3 Komunikime të drejtpërdrejta me komunitetet vendore në përgjithësi dhe grupe specifike në veçanti mbi sistemin e ngritur për identifikimin e rasteve

Pas ngritjes së sistemit të referimit të rasteve 85 takime informuese komunitare do të zhvillohen në një periudhë dy-vjeçare (viti i dytë dhe i tretë i zbatimit të Planit). Format i trainimit (materialet informuese dhe programi) do të përgatiten nga sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social (punonjësi social, NJMF dhe koordinatori vendor kundër dhunës në familje), ndërsa takimet do të realizohen nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të çdo njësie administrative në ndërveprim me kryetarin e fshatit specifik apo ndërlidhësit e komunitetit (në qytete). Me një gjuhë të thjeshtë në takimet me komunitetin do të shpjegohet e drejta për shërbime të kujdesit shoqëror, format e shërbimeve dhe si ata mund të aksesojnë këto shërbime (ku të drejtohen). Kontakti telefonik ku mund të raportohen rastet e individëve në nevojë për shërbime do të theksohet vazhdimisht në çdo takim. Takimet do të përcjellin gjithashtu mesazhe specifike që lidhen me: mbrojtjen e fëmijëve, efektet negative të dhunës dhe nevojën për ta denoncuar atë, nxjerrjen nga izolimi të fëmijëve që kanë një aftësi të kufizuar dhe që stigma i pengon prindërit të kërkojnë shërbime për ta.

Njësia e mbrojtjes së fëmijës dhe koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje do të realizojnë gjithashtu takime informuese të përvitëshme me nxënësit e shkollave 9 vjeçare dhe të mesme duke u fokusuar në tema specifike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, masat kundër dhunës në familje, si dhe referimin e rasteve sociale tek sistemi i ngritur.

Aktiviteti 1.4 Publikimi i sistemit të ngritur

Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social përgatit në një format grafik sistemin e koordinuar të ngritur për identifikimin dhe referimin e rasteve të individëve në nevojë, i cili në mënyrë të thjeshtë shpjegon se ku dhe si duhen raportuar raste të tilla. Ky format grafik publikohet në të gjitha zyrat e Bashkisë që ofrojnë shërbime për qytetarët (në të dy nivelet e organizimit të Bashkisë dhe pranë çdo institucioni pjesë e këtij sistemi (polici, struktura shëndetësore, arsimore, ofrues shërbimesh etj). Gjithashtu ai publikohet në faqen e ëeb të Bashkisë.

Aktiviteti 1.5 Menaxhimi i rasteve dhe referimi tek shërbimet e kujdesit shoqëror

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 578 datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”¹⁸. Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial. Për menaxhimin e rasteve jashtë territorit të njësisë administrative Rrëshen punonjësit e mbrojtjes së fëmijës ndërveprojnë me administratorët shoqëror të njësisë administrative ku ka gjendjen civile fëmija.

Menaxhimi i rasteve të viktimave të dhunës në familje kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”¹⁹. Koordinator i vendor për masa kundër dhunës në familje drejton ekipin teknik ndërdisiplinor (më përfaqësues të institucioneve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues në nivelin vendor. Për menaxhimin e rasteve ndërvepron gjithashtu me administratorët shoqëror sipas vendbanimit të viktimës së dhunës në familje.

¹⁸ <http://differentandequal.org/ep-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>

¹⁹ <http://ëëë.ikub.al/LIGJE/1106160110/article-per-mekanizmin-e-bashkerendimit-te-punes-per-referimin-e-rasteve-te-dhunes-ne-marredheniet-familjare-dhe-menyren-e-procedimit-te-tij-.aspx?cookiesenabled=false>

Për çdo rast tjetër të referuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje menaxhimi i rastit kryhet nga punonjësi social në rastet e njësive administrative Rrëshën, Kaçnar dhe Rubik, ndërsa në njësitë e tjera administrative kryhet nga administratori shoqëror i mbështetur nga punonjësi social i Sektorit të Ndhmës ekonomike dhe shërbimit social.

Për çdo rast që në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes është vlerësuar se duhet të marrë shërbime kujdesi shoqëror menaxheri i rastit do të përgatisë dokumentacionin përkatës në përputhje me VKM nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” dhe do ta referojë tek punonjësi social i sektorit të ndhmës ekonomike. Ky i fundit në përputhje me VKM e sapo cituar ndërmerr procedurat për miratimin e marrjes së shërbimit.

Qëllimi 3.

Ofrim i shërbimeve sipas nevojave përmes sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Objektivi 1. Brenda vitit 2026 nevojat për shërbime të emergjencës, reabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Aktiviteti 1.1. Informimi dhe këshillimi

Informimi dhe këshillimi i ofrohet çdo individ në nevojë për shërbime kujdesi shoqëror me qëllim përfitimin nga shërbime të tilla si përfitimi i ndhmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar, ndihmësi personal, përfitimin nga shërbimet e punësimit, shërbime zhvilluese/reabilituese etj. Ky shërbim ofrohet nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

Aktiviteti 1.2. Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunkionale për fëmijën dhe familjen

Qendra përfshin një numër shërbimesh, të cilat ngrihen gradualisht në përputhje me prioritetin e shërbimit dhe mundësitë buxhetore të Bashkisë. Qendra ngrihet dhe funksionon në përputhje me standartin kombëtar të shërbimit në qendrat multifunkionale, miratuar me Udhëzim të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Shërbimet në këtë Qendër do të ngrihen gradualisht në periudhën tre-vjeçare të zbatimit të planit social dhe do të përfshijnë:

Viti i parë: Ngrihen programe që targetojnë fëmijën dhe familjen

1. Programe këshillimi për prindërimin.
2. Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm
3. Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje
4. Programi i trainimit të familjes kujdestare. Ky program synon të përgatisë familje kujdestare me apo pa lidhje gjaku me fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm.

Viti i dytë: Viojnë shërbimet e ngritura në vitin e parë dhe ngrihen shërbime për fëmijët

1. Shërbim ditor dhe i emergjencës për fëmijët në nevojë për mbrojtje

Qendra ditore ofron shërbim për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike dhe çdo fëmijë në nevojë për shërbime sipas vlerësimit të kryer nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës. Shërbimet përfshijnë ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin. Ky shërbim ngrihet në përputhje me Standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore²⁰.

Për familjet ekstremisht të varfëra me fëmijë ngrihet shërbimi i emergjencës përmes të cilit rasteve të vlerësuara nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit u mundësohen pako ushqimore dhe higjienike si mbështetje e menjëherëshme në periudhën derisa familja merr shërbime të tjera alternative.

2. Shërbim ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara

Shërbimi ngrihet në përputhje me standartet e shërbimit për qendrat ditore të personave me aftësi të kufizuara²¹. Shërbimet ofrohen nga profesionistë: logopedist, fizioterapist, okupacionist, përveç personelit mbështetës dhe synon të nxisë zhvillimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeçare.

Viti i tretë: Viojnë shërbimet e ngritura dhe ngrihen shërbime të reja

Shërbimet në qendrën multifunksionale plotësohen me: **1. Shërbime në shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara** që kanë nevojë për terapi zhvillimi dhe distanca nga qendra multifunksionale i pengon në marrjen e shërbimit. Shërbimi ngrihet në përputhje me standartin e shërbimit

²⁰ Standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore. Aksesuar nga http://ëëë.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/54-2013.pdf

²¹ Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara në institucionet rezidenciale dhe ditore. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ëp-content/uploads/2014/02/Vendim-i-KM_822_06.12.20061.pdf

asistencë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara²². **2. Shërbime në shtëpi për të moshuarit** që jetojnë vetëm ngrihen në përputhje me standartin e shërbimit asistencë shtëpiake për të moshuarit²³.

Aktiviteti 1.3 Shërbim i emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje

2 apartamente të mbrojtura shërbejnë për të akomoduar rastet e viktimave të dhunës në familje të pajisura me urdhër të menjëhershëm mbrojtje. Shërbimi përfshin: Strehimi, veshje (për rastet kur viktimat e ka të pamundur të aksesoj edhe përkohësisht shtëpinë), ushqimin, shërbim psikologjik, shërbime mjekësore, shërbime juridike, formim profesional, punësim, mbështetje me ndihmë ekonomike, asistencë edukative/arsimore. Kjo formë shërbimi kombinohet me shërbimet që mundësohen në qendrën multifunkionale në përputhje me nevojat e vlerësuar për shërbime nga grupi teknik ndërsektorial.

Aktiviteti 1.4 Shërbimi i strehimit social

Përmes programit bonusi i qerasë Bashkia do të trajtojë çdo vit me prioritet familje që kanë pamundësi për të përballuar koston e strehimit dhe në mënyrë të veçantë: Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë grua kryefamiljare; Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë më shumë se 2 fëmijë të mitur; Familje egjiptiane; Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë të paktën një pjestar me aftësi të kufizuara; Viktima të dhunës në familje.

Aktiviteti 1.5 Rritje e aksesit të personave me aftësi të kufizuara

Drejtoria e urbanistikës respekton në projektet infrastrukturore kriteret mbi garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në godinat dhe mjediset publike.

²² <http://ëëë.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2014/03/udhezim-597-dt.22.12.17.pdf>

²³ Udhëzim 581 datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake për të moshuarit. Aksesuar në: http://ëëë.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2014/03/Udh%C3%ABzim_581_18.12.2017.pdf

Qëllimi 4.

Riintegrim ekonomik dhe social për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

Objektivi 1. Fuqizim ekonomik dhe riintegrim i të paktën 20% të individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

Aktiviteti 1.1. Mekanizmi lokal për fuqizimin ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe grupeve në nevojë

Punonjësi social i sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për taksat do të ndërtojë bazën e të dhënave të bizneseve që kanë potenciale punësimi në të gjithë territorin e Bashkisë. Në përfundim të këtij procesi Bashkia do të thërras në një tryezë të gjithë drejtuesit e bizneseve për të ngritur rrejetin që mbështet fuqizimin ekonomik të familjeve dhe individëve pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme. Në tryezë do të ketë gjithashtu përfaqësues të Zyrës së Punës, Qendrës Rajonale të Formimit Profesional, Shkollës së mesme profesionale jo publike, Agjensisë së Zhvillimit të Bujqësisë dega Rajonale Lezhë, si dhe organizatave joqeveritare që zhvillojnë projekte të fuqizimit ekonomik në territorin e Bashkisë (të tilla si “ Caritas”, World Vision etj). Tryeza do të synojë të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve që kanë kapacitete për punësim për nevojën e përfshirjes në tregun e punës së individëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Do të diskutohen gjithashtu forma të ndërveprimit mes Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-AZHB- Formimit profesional me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve dhe zbatjes së varfërisë në këtë Bashki. Mbi bazën e konkluzioneve të tryezës punonjësi social do të ndërtojë një Plan-Veprimi me aktorësh me target punësimin e familjeve dhe individëve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Në secilin nga dy vitet pasuese të këtij Plani kjo tryezë do të rimblidhet për të diskutuar mbi rezultatet, sfidat dhe përmirësimet e mundshme.

Aktiviteti 1.2. Programe për formimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës në Bashkinë Mirditë

Në vijim të Tryezës ndër-institucionale do të ngrihet një grup teknik për të kryer një vlerësim më të thelluar të karakteristikave të tregut të punës në Bashkinë Mirditë. Synimi do të jetë identifikimi i profileve të ndryshme të punës në mënyrë që edhe formimi profesional të jetë i orientuar drejt atyre kurseve që i përgatisin realisht për punë individët në moshë pune të

familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Grupi teknik do të drejtohet nga sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social dhe do të përbëhet të paktën nga : përfaqësues të Zyrës së Punës, formimit profesional (përfshirë shkollën profesionale jopublike), organizatat që punojnë në territor për fuqizimin ekonomik të familjeve më të varfëra.

Një nga produktet e punës së këtij grupi do të jetë listimi i profesioneve që mund të ushtrohen realisht në territorin e Bashkisë në përputhje me karakteristikat e tregut të punës. Në përputhje me këtë listë shërbimet e formimit profesional orientojnë kurset që i ofrojnë individëve në kërkim të një pune.


Aktiviteti 1.3 Këshillimi për punësim

Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social rrit ndërveprimin me Zyrën e Punës. Kjo e fundit ka detyrë funksionale këshillimin dhe ofrimin e punës për punëkërkuuesit. Në kushtet që distanca mes Zyrës së Punës dhe përfituesve të ndihmës është e madhe, një përfaqësues i Zyrës së Punës së bashku me administratorin shoqëror të njësisë administrative përkatëse kryen këshillimin për punësim me individët në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike pranë njësisë administrative. Këshillimet zhvillohen dy herë në vit pranë çdo njësie administrative.

Aktiviteti 1.4 Programe të nxitjes së punësimit

Ky program do të përfshijë të paktën: **1. Punësim i të rinjve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.** Çdo vit 5 të rinj të sapodiplomuar, kryesisht të familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, do të punësohen për gjashtë muaj sipas profesionit që kanë në biznese lokale apo në Bashkinë Mirditë. Bashkia do të financojë për pagat e tyre në masën 26.000 lekë/muaj. **2. Sipërmarrjet sociale.** Bashkia do të shfrytëzojë hapësirat që krijon ligji “Për ndërmarrjet sociale”, sikurse praktikantët e ngritura tashmë nga dy organizatat “World Vision” dhe “Caritas” të cilat përmes projekteve të tyre kanë trainuar dhe kanë financuar ngritjen e bizneseve për një numër familjesh në pjesë të ndryshme të Bashkisë. Studimi mbi karakteristikat e tregut të Punës në këtë Bashki do të ndihmojë për të identifikuar tipe biznesesh që sigurojnë të ardhura për familjet, ndërsa grupet që do të targetojnë këto biznese do të përzgjidhen mbi bazën e analizës së vulnerabilitetit që ka mundësuar ky Plan Social.

NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË KOORDINUAR KOMUNITAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani është parashikuar të zbatohet për një periudhë tre vjeçare dhe për çdo aktivitetet është përcaktuar koha e zbatimit duke vlerësuar si prioritetin e ndërhyrjes, ashtu edhe kapacitetet financiare për të zbatuar Planin Social në hapësirën kohore të parashikuar. Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësia zbatuese e aktivitetit specifik. Zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, por partneriteti me organizata ofruese shërbimesh, institucione publike lokale e rajonale, si dhe grupe interesi është tejet i rëndësishëm për të mundësuar përmbushjen e objektivave të këtij Plani. Në Plan janë identifikuar partnerët kyç, por zbatimi i Planit dhe kushtet në ndryshim bëjnë të nevojshëm që Sektori Social ta zgjeroj vazhdimisht këtë rrjet partnerësh.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Për rishikimin e Planit janë parashikuar masa konkrete pjesë e Qëllimit 1/Aktiviteti 2.4 “Zhvillimi i praktikës së punës për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e situatës së grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë”. Përveç mbledhjes dhe analizës periodike të treguesve socialë Sektori Social do të zhvilloj çdo vit dëgjesa me secilin prej grupeve vulnerabël e veçanërisht me: fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit. Pas ngritjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuar në këtë Plan, kjo strukturë si pjesë e procesit të monitorimit të cilësisë së shërbimeve do të zhvilloj intervista/fokus grupe me përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre shërbimeve.

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësia/të përgjegjëse për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit.

Monitorimi i jashtëm do të lehtësoj gjithashtu proceset e monitorimit dhe të vlerësimit. Bazuar në detyrimet ligjore, disa prej aktivitetëve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriat Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

5. PLANI I VEPRIMIT

QËLLIMI 1 – THELLIM I ROLIT DHE FUNKSIONIT TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE TË MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 1. Brenda vitit 2021 do të riorganizohet struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dhe do të ngrihen e funksionojnë Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit							
Aktiviteti 1.1: <i>Rishikim i strukturës, roleve dhe funksioneve të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki</i>	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social <i>Drejtoria e burimeve njerëzore</i>	Nëntor-dhjetor 2020	Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe	Bashkia	20.736.000	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>

			përgjegjëse dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;	mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për asistencën sociale"			
Aktiviteti 1.2: <i>Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në nivelin e Njësive administrative</i>	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social Drejtoria e burimeve njerëzore	Nëntor-dhjetor 2020	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën e Nj.V.N.R në njësinë administrative dhe	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	Bashkia	19.296.000	Sekretari i Përgjithshëm

			çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;				
Objektivi 2: Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror							
Aktiviteti 2.1 <i>Trainime të stafit të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit</i>	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social	2020 2021 2022	Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë; Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”	Bashkia Partneritet me SHSSH dhe organizata joqeveritare	90.000	Sekretari i Përgjithshëm

				Ligji "për asistencën sociale" Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Ligji "Për prokurimin Publik"			
Aktiviteti 2.2 Vizita studimore	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social	2020 2021	Vizitat e kryera në qendra komunitare/shërbime sociale në përputhje me tipin e shërbimit që do të ngrihet; Praktikat e reja dhe shërbimet e ngritura në vijim të eksperiencës së fituar nga vizitat studimore të kryera;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore"	Bashkia në partneritet me SHSSH, ofruesit s shërbimeve në qakun e Lezhës/Tiranë;	78.000	Sekretar i Përgjithshëm
Aktiviteti 2.3	Sektori i Ndihmës ekonomike dhe	2020	Intervistimi i fëmijëve, viktimave	Ligji "Për shërbimet e	Bashkia	216.000	Sekretari i

<i>Krijimi i infrastrukturës së punës së Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social si dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit</i>	shërbimit social	2021	të dhunës në familje apo çdo rasti që ka të nevojshëm sigurimin e konfidencialitetit kryhet në ambiente të përshtatshme; Protokollet e punës të përgatitura dhe personeli i njeh dhe i zbaton në praktikën e punës; Paketa e formularëve të vlerësimit dhe menaxhimit të rasteve për çdo grup në nevojë e përgatitur dhe përdoret nga personeli gjatë praktikës së punës; Personeli njeh dhe përditëson vazhdimisht Rregjistrin Elektronik të	kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "për asistencën sociale" VKM “Mbi Rregjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të			Përgjithshëm
--	------------------	------	---	--	--	--	--------------

			Shërbimeve Sociale;	Kujdesit Shoqëror			
Aktiviteti 2.4 <i>Zhvillimi i praktikës së punës për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e situatës së grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë.</i>	Spektori i Ndhmës ekonomike dhe shërbimit social	2020 2021 2022	Lista e treguesve që do të mblidhen; Frekuenca e mbledhjes së çdo treguesi; Burimi nga do të sigurohet mbledhja e të dhënave; Shkresat zyrtare drejtuar institucioneve që zotërojnë të dhënat e nevojshme; Raporti Vjetor i aktivitetit për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkinë Mirditë Plani Social i rishikuar duke patur reference edhe	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "për asistencën sociale"	Bashkia	90.000	Sekretari i Përgjithshëm

			analizën e grupeve në nevojë; Numri i konsultimeve të zhvilluara me fëmijët; Numri i konsultimeve të zhvilluara me gratë; Numri i konsultimeve të zhvilluara me grupe në nevojë; Ndryshimet e ndodhura në planet dhe buxhetin lokal sipas propozimeve të marra nga konsultimet e zhvilluara;	Ligji "Për të drejtën e informimit publik"			
--	--	--	---	---	--	--	--

QËLLIMI 2- RRRITJE E RASTEVE TË IDENTIFIKUARA TË INDIVIDËVE NË NEVOJË PËR MBROJTJE DHE PËRKUJDESJE

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJË S	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 1: Brenda vitit 2021 do të ngrihet dhe do të jetë funksional sistemi i referimit dhe menaxhimit të rastit							
Aktiviteti 1.1 <i>Ngritja e sistemit të koordinuar të referimit të rasteve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje</i>	Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social	Janar 2020	Data base e ngritur dhe përmban të dhëna me pika kontakti për çdo institucion lokal, rajonal, kombëtar, organizata ofruese shërbimesh në nivel rajoni; Aksesi në bazën e të dhënave i stafit në nivelin e Bashkisë dhe NjVNR sipas fushës së përgjegjësisë; Numri i	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për asistencën sociale" Ligji "Për të drejtën e	Bashkia	100.000	Sekretari i Përgjithshëm

			pjesëmarrësve dhe institucionet që përfaqësojnë në tryezën ku prezantohet sistemi i ngritur i referimit; Përfshirja në këtë sistem e institucioneve të synuara;	informimit publik"			
Aktiviteti 1.2 <i>Qartësimi i rolit të sistemit të koordinuar për mbështetjen e komuniteteve me shërbime</i>	Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social	Shkurt 2020	Pjesëmarrësit dhe institucionet që përfaqësojnë në tryezën e zhvilluar janë në përputhje me objektivin e tryezës; Pjesëmarrësit dhe institucionet që përfaqësojnë kanë qartësi të plotë mbi sistemin e referimit dhe	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien	Bashkia	81.000	Sekretari i Përgjithshëm

			detyrat e tyre si pjesë e tij; Numri i rasteve në nevojë për shërbime shoqërore të identifikuar dhe të referuara në vijim nga pjesëmarrësit/institucionet që përfaqësojnë;	familjare”			
Aktiviteti 1.3 <i>Komunikime të drejtpërdrejta me komunitetet vendore në përgjithësi dhe grupe specifike në veçanti mbi sistemin e ngritur për identifikimin e rasteve</i>	Punonjësi social Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje Njësiti e Vlerësimi të	Shkurt-dhjetor 2021 2022	Numri i takimeve të zhvilluara; Numri i individëve të informuar në sajë të takimeve të zhvilluara; Çështjet e diskutuara e të prezantuara në çdo takim janë në përputhje me	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien	Bashkia	180.200	Përgjegjësi i Sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social

	Nevojave dhe Referimit		prioritetet e përcaktuara në Planin Social; Rritje e numrit të individëve që janë referuar pranë sistemit të referimit për të marrë shërbime të kujdesit shoqëror;	familjare”			
Aktiviteti 1.4 Publikimi i sistemit të ngritur	Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimti social	2020	Numri i institucioneve publike që kanë afishuar të dhënat mbi sistemin e referimit; Faqja eeb e përditësuar me informacion që ka interes për publikuan	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për asistencën	Bashkia	100.000	Sekretari i Përgjithshëm

				sociale"			
				Ligji "Për të drejtën e informimit publik"			
Aktiviteti 1.5 Menaxhimi i rasteve dhe referimi tek shërbimet e kujdesit shoqëror	Punonjësi social PMF Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje Punonjësit socialë të Nj.V.N.R të njësive administrative	Vazhdimi sht	Numri i rasteve të të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale; Numri i rasteve që individit është mbështetur me shërbime dhe/ose fuqizuar; Numri i takimeve ndërsektoriale të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takime; Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës	Bashkia	900.000	Përgjegjësi i Sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social

			praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara;	për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.			
--	--	--	---	--	--	--	--

QËLLIMI 3 - OFRIM I SHËRBIMEVE SIPAS NEVOJAVE PËRMES SISTEMIT KOMUNITAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 1. Brenda vitit 2023 nevojat për shërbime të emergjencës, rehabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror							
Aktiviteti 1.1. <i>Informimi dhe këshillimi</i>	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Vazhdimi sht	Numri i individëve të informuar e këshilluar; Numri i	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” VKM 518/2018 “Për	Bashkia	0	Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

			individëve të referuar tek shërbimet specifike të kujdesit shoqëror sipas nevojave të identifikuar të tyre;	shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”			
Aktiviteti 1.2. <i>Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunkionale për fëmijën dhe familjen</i>	Sektori i Ndhmës ekonomike dhe shërbimit social	2020 2021 2022	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”	Fondi Social (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia)	38.961.000	Sekretari i Përgjithshëm

			specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit; Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra;	Standarti Kombëtar i miratuar me Udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standartit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”			
Aktiviteti 1.3 <i>Shërbim i emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje</i>	Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje	2021	Streha e emergjencës funksionale për çdo rast; Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim; Numri i rasteve të akomoduara në kushtet e emergjencës; Numri i rasteve që	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Ligji "për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre	Fondi Social (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia)	3.648.000	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social

			kanë përfituar shërbimin ligjor dhe psikologjik;	dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Vendim nr.505, datë 13.7.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”			
Aktiviteti 1.4 Shërbimi i strehimit social	Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social Spektori i urbanistikës	2020 2021 2022	Numri i familjeve që kanë përfituar bonus qeraje/strehim social në raport me numrin e familjeve që kanë	Ligj "Për strehimin social" Ligj "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Bashkia dhe Ministria e Financave	28.800.000	Sekretari i Përgjithshëm

			në përbërje persona me aftësi të kufizuara, gra kryefamiljare, viktima të dhunës në familje, apo individë në nevojë të identifikuar në Planin Social.				
Aktiviteti 1.5 <i>Rritje e aksesit të personave me aftësi të kufizuara</i>	Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social Sektori i urbanistikës	2020 2021 2022	Raporti i vlerësimit identifikon qartësisht godinat/ mjediset ku duhet të ndërhyhet për ti bërë të aksesueshme. Investime të ndërmarra me qëllim garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedise publike.	Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Bashkia	0	Sekretari i Përgjithshëm

QËLLIMI 4- RIINTEGRIM EKONOMIK DHE SOCIAL PËR FAMILJET PA TË ARDHURA OSE ME TË ARDHURA TË PAMJAFTUESHME

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 1. Fuqizim ekonomik dhe riintegrim i të paktën 20% të individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike							
Aktiviteti 1.1. <i>Mekanizmi lokal për fuqizimin ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe grupeve në nevojë</i>	Punonjësja sociale/Spektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit Social Spektori i Tatim Taksave	2020 Rishikim 2021 2022	Baza e të dhënave të bizneseve dhe institucioneve e organizatave partnere e ngritur; Programi dhe Tryeza e zhvilluar janë në përputhje me objektivin e këtij aktiviteti; Janë identifikuar forma të	Ligji “Për asistencën sociale” Ligji “Për nxitjen e Punësimit” Ligji “Për ndërmarrjet sociale”	Bashkia Partneritet me Zyrën e Punës, Qendrën Rajonale të Formimit Profesional Lezhë, Agjensinë e Zhvillimit të Bujqësisë dega Rajonale Lezhë,	18.000	Kabineti i Kryetarit të Bashkisë Sekretari i Përgjithshëm

			ndërveprimet mes Bashkisë-biznesit- Zyrës së Punës- AZHBR- Formimit profesional - organizatave me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve dhe zbutjes së varfërisë në këtë Bashki; Plani i Veprimit për fuqizimin ekonomik i hartuar brenda vitit të parë dhe monitorohet e rishikohet çd vit; Numri i individëve nga grupet në nevojë të punësuar përmes masave të zbatuara të këtij Plani;		si dhe organizatave joqeveritare territorin e Bashkisë (Caritas, World Vision etj)		
Aktiviteti 1.2. Programe për formimin	Punonjësi social/sektori i ndihmës	2020	Grupi teknik ka në përbërje përfaqësues të institucioneve që	Ligji “Për asistencën sociale”	Bashkia Në partneritet	0	Sekretari i Përgjithshëm

profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës në Bashkinë Mirditë	ekonomike dhe shërbimit social Përfaqësues të: Zyrës së Punës, formimit profesional, “Caritas”, “World Vision” dhe organizata të tjera të identifikuar përgjatë zbatimit të Planit		kanë role e përgjegjësi në drejtim të formimit profesional; Lista e profesioneve për territorin e Bashkisë e hartuar; Numri i kurseve të formimit profesional të ofruara për individët në nevojë në përputhje me listën e profesioneve të identifikuar;	Ligji “Për nxitjen e Punësimit”	me Zyrën e Punës; Qendrën e Formimit Profesional; Organizatat joqeveritare partnere;		
Aktiviteti 1.3 Këshillimi për punësim	Administratorët shoqëror Në partneritet me Zyrën e Punës	2021 2022	Numri i individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, apo individëve në situatë të pafavorshme të takuar e këshilluar për punësim; Numri i individëve madhorë të familjeve	Ligji “Për asistencën sociale” Ligji “Për nxitjen e Punësimit” Urdhëri i Përbashkët i Ministres së Financës dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi Protokollin e	Bashkia Zyra e Punës	0	Zv. Kryetari Sekretari i Përgjithshëm

			përfituese të ndihmës ekonomike, apo individëve në situatë të pafavorshme të punësuar;	Bashkëpunimit mes SHSSH dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (gusht 2019)			
Aktiviteti 1.4 Programe të nxitjes së punësimit 1. Punësim i të rinjve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. 2. Sipërmarrjet sociale.	Punonjësi social/sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social Partneritet me Zyrën e Punës, formimin profesional, “Caritas”, “World Vision” dhe organizata të tjera të identifikuar përgjatë zbatimit të Planit	2021 2022	Numri i të rinjve, pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, të punësuar Numri i bizneseve sociale të ngritura; Numri i individëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, viktimave të dhunës në familje, personave me aftësi të kufizuara të punësuar në bizneset sociale të ngritura;	Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për ndërmarrjet sociale”	Bashkia Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Donatorë	4.800.000	Zv. Kryetari Sekretari i Përgjithshëm

6. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT

Tabela 6: Përmbledhje buxheti sipas qëllimeve dhe objektivave

QËLLIMI	OBJEKTIVI	BUXHETI TOTAL	BUXHETI I BASHKISË VITI 1	HENDEKU I FINANCIMIT VITI 1
Qëllimi 1. Thëllim i rolit dhe funksionit të strukturave përgjegjëse të mbrojtjes dhe kujdesit social.	Objektivi 1. Brenda vitit 2021 do të riorganizohet struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dhe do të ngrihen e funksionojnë Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	40 032 000	10 008 000	3 336 000
	Objektivi 2. Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror	474 000	0	120 000
Qëllimi 2. Rritje e rasteve të identifikuar të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.	Objektivi 1: Brenda vitit 2021 do të ngrihet dhe do të jetë funksional sistemi i referimit dhe menaxhimit të rastit	1 361 200	100 000	481 000
Qëllimi 3. Ofrim i shërbimeve sipas nevojave përmes sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit	Objektivi 1. Brenda vitit 2023 nevojat për shërbime të emergjencës, rehabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen	71 409 000	0	13 624 000

<i>shoqëror</i>	<i>përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror</i>			
<i>Qëllimi 4. Riintegrim ekonomik dhe social për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.</i>	<i>Objektivi 1. Fuqizim ekonomik dhe riintegrim i të paktën 20% të individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike</i>	4 818 000	0	6 000

Zbatimi i plotë i Planit Social të Bashkisë Mirditë në periudhën tre vjeçare 2021-2023 kërkon që Fondi Social i kësaj Bashkie të jetë 118.094. 200 lekë. Plani është ndërtuar në mënyrë të tillë që ti japë kohë Bashkisë përgjatë vitit të parë që paralelisht me konsolidimin e strukturave të saj për të ngritur sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror të punojë për thithjen e fondeve të nevojshme për zbatimin e komponentëve të Planit nga dy burime kryesore: 1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 2. Donatorë.

Për vitin e parë të zbatimit të Planit Social Bashkia duhet të alokojë një fond prej 10.108.000 lekë, të cilat në fakt ajo i zotëron sepse janë fonde të përvitëshme, kryesisht paga dhe sigurime shoqërore. Për vitin e parë asaj i duhet të sigurojë një fond prej 17.567.000 lekë (hendeku i financimit). Miratimi i këtij Plani që në vitin 2020 i jep asaj kohë për të punuar për sigurimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e komponentëve të Planit të parashikuara në vitin e parë.

Në shtojcën 4 prezantohet në mënyrë të detajuar përlllogaritja e fondeve për çdo aktivitet të parashikuar në Plan dhe të shtrirë në periudhën tre vjeçare të zbatimit të tij.

REFERENCAT

Ligje

1. Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
2. Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"
3. Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
4. Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit",
5. Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"
6. Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit "
7. Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"
8. Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit"
9. Ligji 22/2018 "Për strehimin social"
10. Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

Strategji Kombëtare

1. Vendim nr. 1071, datë 23.12.2015, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2015-2020 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"
2. Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020.
3. Vendim nr.87, datë 3.6.2016 "Për miratimin e dokumentit politik të përfshirjes sociale 2016-2020".

VKM në zbatim të ligjit

1. VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".
2. Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës".
3. VKM Nr.334, datë 17.2.2011, "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij"
4. VKM Nr.233, datë 10. 4.1998 "Për zbatimin e Ligjit "Për statusin e jetimit"

5. VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
6. VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.
7. Vendimin nr. 150, datë 20.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

Urdhëra/Udhëzime Ministri

1. Urdhër nr. 624, datë 20.08.2016 “Për miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike 2019-2020”

SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Të dhëna demografike

Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshave

Njësia Administrative	Numri Popullsisë	Numri Familjeve	Popullsia sipas grup moshave				
			0-6 vjeç	7-15 vjeç	16-18 vjeç	19-64 vjeç	65+ vjeç
Rreshen, Kaçinar	16 019	5 168	1 003	1 750	660	10 816	1 790
Rubik	7 880	2 654	448	831	329	5 335	937
Fan	4 380	1 389	362	589	212	2 756	461
Kthelle, Selite	4 836	1 568	349	627	197	3 069	594
Orosh	2 979	1 061	194	315	116	1 999	355
TOTALI	36 094	11 840	2 356	4 112	1 514	23 975	4 137

Ndihma ekonomike

Për të identifikuar familjet përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe karakteristikat kryesore të tyre të dhënat u morrën nga Rregjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike, të aksesuara nga Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale në Bashkinë Mirditë.

Tabela 2. Të dhëna të krahasuara për familjet aplikuese dhe përfituese të NE 2018-2020

NJESIA ADMINISTRATIVE	DHJETOR 2018				MARS 2020			
	FAMILJE APLIKUESE	FAMILJE PËRFITUESE			FAMILJE APLIKUESE	FAMILJE PËRFITUESE		
		RURAL	URBAN	% PRANIMIT		RURAL	URBAN	% PRANIMIT
Fan	289	273	0	94	233	223	0	96
Kaçinar	131	112	0	85	85	80	0	94

Kthelle	157	156	0	99	133	123	0	92
Orosh	120	76	15	76	74	55	18	99
Rreshen	274	171	62	85	239	146	83	96
Rubik	160	130	21	94	130	96	30	97
Selite	116	83	10	80	88	68	10	89
TOTALI	1247	1001	108	89	982	791	141	95

Në dhjetor 2018, viti kur u aplikua për herë të parë modeli i ri i përfitimit të ndihmës ekonomike, 1247 familje aplikuan për ndihmë ekonomike dhe 1,109 familje e përfituan atë. Në mars 2020 vihet re një rënie me 21% e numrit të aplikimeve për ndihmë ekonomike, krahasuar me dhjetor 2018, si dhe një rënie me 16% të numrit të familjeve përfituese të kësaj ndihme. Nga intervista me përgjegjësen e sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale konkludojmë se rënia në numrin e aplikimeve lidhet me kalimin në një sistem të ri të përfitimit të ndihmës ekonomike në vitin 2018. Heqja e kriterëve të mëparëshme përjashtuese nxiti shumë familje të aplikonin për herë të parë për ndihmë ekonomike. Mos dalja fitues pas disa riaplikimesh është një nga shkaqet kryesore të rënies së numrit të aplikimeve. Rënia në numrin e përfituesve në 2020 krahasuar me vitin 2018 duket se ka disa arsye: mosparaqitja qoftë edhe një pjesëtar madhor të një familje për deklarin tre mujor ka sjellë largimin nga skema të të gjithë familjes; deklarinmet e pasakta apo të rreme janë një tjetër arsye. Gjithsesi rënia e numrit të përfituesve të ndihmës ekonomike në një masë shumë të vogël lidhet me punësimin e pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Për dy periudhat e krahasuara vihet re gjithashtu që kemi një rritje në nivelin e pranueshmërisë në skemën e ndihmës ekonomike. Në vitin 2018, 89% e familjeve aplikuese përfituan ndihmë ekonomike dhe në vitin 2020 kemi 95% të familjeve aplikuese që kanë përfituar ndihmën ekonomike. Administratorët shoqërorë kanë rritur performancën e tyre, pasi janë shmangur gabimet që ndodhnin në vitin e parë të aplikimit të këtij modeli të ri.


Niveli i pranueshmërisë në skemë duket se është përmirësuar më shumë për familjet aplikuese në zonën urbane. Konkretisht në vitin 2018 niveli i pranueshmërisë për këto familje ishte 10,7% ndërsa në mars 2020 ishte 15%. Megjithatë niveli më i lartë i varfërisë mbetet në zonën rurale.

Tabela 3. Familje në skemën e NE krahasuar me familjet sipas gjendjes civile

NJESIA ADMINISTRATIVE	Familje gjendje civile	Familje me NE	Familje përfituese nga fondi 6%	% (familje NE/totalit familje)
Rrëshën	5168	182	47	6%
Kaçinar		71	9	
Kthelle	1568	118	5	13%
Selitë		72	6	
Fan	1389	214	9	16%
Rubik	2654	105	21	5%
Orosh	1061	65	8	7%
TOTALI	11840	827	105	8%

Kundrejt totalit të 11,840 familjeve të rregjistruara në gjendjen civile 932 familjet përfituese të ndihmës ekonomike në mars 2020 përbëjnë 7,9% të totalit të familjeve. Nëse do ti referoheshim të dhënave të censusit përqindja që zenë familjat përfituese të ndihmës ekonomike në totalin e familjeve që jetojnë fizikisht në këtë Bashki është 13%.

Grafik 1: Shpërndarja në territor e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike




Siç tregohet në grafikun 1 përqindjen më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike e gjejmë në njësitë administrative Rrëshën, Kaçinar, Fan, Kthellë e Selitë.

Theksojmë se përveç fondeve të qeverisë qendrore Bashkia Mirditë deri në qershor 2019 ka aplikuar nga të ardhurat e saj një fond prej 160 mijë lekë për të mbështetur familje të varfëra që nuk përfitonin ndihmë nga programi kombëtar.

Por nëse i referohemi raportit familje përfituese të ndihmës ekonomike kundrejt totalit të familjeve për çdo njësi administrative shohim se njësitë administrative më të varfëra rezultojnë të

jenë njësitë administrative Fan (34%), Kthellë e Selitë (28%) dhe Orosh (15%). Grafiku 2 prezanton këtë situatë.

Grafik 2: Përqindja e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike kundrejt totalit të familjeve në çdo njësi administrative



Pavarësisht numrit të lartë të përfituesve aktualisht në skemën e ndihmës ekonomike, përgjatë periudhës së pandemisë stafi i strukturës përgjegjëse për ndihmën ekonomike dhe shërbimet punoi në terren me familjet dhe arriti të identifikojë familje që edhe pse të varfëra nuk kishin aplikuar për ndihmë ekonomike. Mungesa e aplikimit kish ndodhur për arsye të ndryshme: neglizhencë e vetë familjeve, mungesë informacioni etj. Gjatë periudhës së pandemisë me një fond prej 200 mijë lekë Bashkia Mirditë ka mbështetur me pako ushqimore familje të varfëra në territorin e saj.


Individë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike²⁴ në mars 2020 ishin 3424 persona. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është 3,7 pjesëtarë, pra më i lartë se mesatarja e pjesëtarëve të familjeve në territor (3,04). Pra familjet me numër më të madh pjesëtarësh janë përgjithësisht më të varfëra. Përbërja e këtyre familjeve sipas grupmoshave :

- 840 individë të grupmoshës 0-18 vjeç (25% e pjesëtarëve)
- 2524 individë në moshë 19-64 vjeç (73% e pjesëtarëve)
- 60 individë në moshë mbi 64 vjeç (2% e pjesëtarëve)

Në grafikun 3 krahasohet për çdo grupmoshë numri i individëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike me individët e po të njëjtës grupmoshë pjesë e popullatës së Bashkisë.

Grafik 3: Krahasimi i grupmoshave

Në nivel Bashkie 9,5% e individëve jetojnë përmes ndihmës ekonomike. 10% e fëmijëve në Bashkinë Mirditë janë pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. 11% e



²⁴Të dhëna të mars2020

grupmohës 19-64 vjeç janë pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës dhe vetëm 1,5% e grupmohës mbi 64 vjeç përfiton ndihmën ekonomike. Ka shumë të moshuar në nevojë, por të papërfshirë në skemë. Kanë pensione minimale, jetojnë në shtëpi me qera, ndërkohë që fëmijet e tyre jetojnë jashtë Shqipërisë.

Disa nga karakteristikat e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të identifikuar përmes të njëjtit burim (Rregjistrat Elektronik të Ndihmës Ekonomike) janë shprehur në tabelën 5²⁵.

Tabela 4: Karakteristikat e familjeve përfituese të NE

NJËSIA ADMINISTRATIVE	TOTAL Familje përfituese të NE	KARAKTERISTIKAT					
		Kryefamiljare grua	Deri në 2 fëmijë të mitur	Mbi 2 fëmijë të mitur	Rome/ egjiptiane	Me të paktën 1 anëtar PAK	Të paktën 1 pjestar në moshë pensionari
Fan	214	12	0	58	0	4	
Kaçinar	71	8	0	3	0	2	
Kthelle	118	9	0	20	0	2	
Orosh	65	7	0	11	0	2	
Rreshen	182	22	0	39	27	5	
Rubik	105	11	0	17	0	5	
Selite	72	6	0	6	0	2	
TOTALI	827	65	0	154	27	22	0

Nga të dhënat e mësipërme duket qartë se:

- 8 % e familjeve përfituese kanë grua kryefamiljare;
- 19% e familjeve kanë më shumë se 2 fëmijë të mitur;
- 3% e familjeve janë familje egjiptiane. Janë 52 familje egjiptiane që jetojnë në njësine administrative Rreshen dhe vetëm 27 prej tyre kanë kushte të vështira ekonomike.
- 3% e familjeve kanë të paktën një pjestar me aftësi të kufizuara.

²⁵ Të dhënat i referohen vetëm familjeve përfituese nga skema kombëtare dhe nuk janë përfshirë të dhënat për familjet përfituese nga fondi 6%

Punëkërkes të papunë

Për të analizuar situatën në lidhje me nivelin e papunësisë dhe karakteristikat e punëkërkesve të papunë në Bashkinë Mirditë u përdorën të dhëna nga Zyra e Punës. Sipas të dhënave të muajit Mars 2020 në Zyrat e Punës janë të regjistruar si punëkërkes 529 persona banues të Bashkisë Mirditë.

Nëse i referohemi të dhënave të gjendjes civile për numrin e popullsisë në moshë aktive pune (23,975 individë) konkludojmë se 2,2% e tyre janë punëkërkes të regjistruar në Zyrat e Punës.

Vajzat dhe gratë janë në përqindjen më të lartë në kërkimin e një pune, pasi siç shihet 59% e punëkërkesve janë femra dhe 41% janë meshkuj (shih tabela 5).

66% e punëkërkesve të papunë kanë moshë mbi 40 vjeç. Vetëm 1 person me aftësi të kufizuara është i regjistruar si punëkërkes i papunë. 8% e punëkërkesve janë romë/egjiptianë, 7% emigrantë të kthyer dhe 9% janë gra kryefamiljare.

Tabela 5: Të dhëna mbi papunësinë sipas karakteristikave të përgjithshme në nivel Bashkie


Bashkia	Grupmosha	Sipas gjinisë		Sipas statusit			
		Femra	Meshkuj	PAK	Romë/ Egjiptjane	Emigrantë të kthyer	Gra kryefamiljare
MIRDITË	16-19 vjec	5	3		2	0	0
	20-24 vjec	21	23		1	6	7
	25-29 vjec	27	15		6	11	6
	30-39 vjec	64	24	1	12	15	7
	40+	195	152		21	3	26
	Total	312	217	1	42	35	46

Niveli arsimor duket se ka ndikim të konsiderueshëm në pamundësinë e një oferte pune. 85% e punëkërkesve në Bashkinë Mirditë kanë arsim nëntëvjeçar ose të mesëm të përgjithshëm.

Grafiku 4. Papunësia sipas nivelit arsimor

Arsimi i përgjithshëm nuk ofron mundësinë e një profesioni e për rrjedhojë vështirëson përpjekjet për sigurimin e një vendi pune.


Përqindja më e ulët e punëkërkuësve është mes atyre me arsim profesional (6,6%) dhe arsim universitar (6%).



Grafiku 5: Krahësimi femra/meshkuj

Egziston një diferencë në nivelin arsimor mes femrave dhe meshkujve të regjistruar në zyrat e punës. Femrat me arsim 9 vjeçar dhe të mesëm të përgjithshëm zënë 60% të këtij grupi.

Nuk u identifikuan analiza më të thelluara për shkaqet që bëjnë të pamundur punësimin e femrave pavarësisht se kanë një profesion.



Aftësia e kufizuar

818 persona në Bashkinë Mirditë janë vlerësuar nga komisionet mjeksore me të paktën një formë të aftësisë së kufizuar. Referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë 2,3% e popullsisë së

kësaj Bashkie është përfshirë në programin e pagesave cash të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar. Nga 818 persona me aftësi të kufizuar 212 prej tyre (26%) kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për pasojë kanë një ndihmës (kujdestar) që kujdeset për ta. 76% e personave me aftësi të kufizuar kanë probleme të shëndetit fizik/mendor dhe ata përbëjnë grupin më të madh të aftësisë së kufizuar në këtë Bashki.


Tabela 6. Të dhëna për personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative

NJESIA	GJITHSEJ		TE VERBER		PARA-TETRA	PLEGJIK	PAK FIZIK	MENDOR
	Gjithsej	Me kujdestar	Gjithsej	Me kujdestar	Gjithsej	Me kujdestar	Gjithsej	Me kujdestar
TOTALI BASHKI	818	212	144	41	52	52	622	119
Fan	111	28	11	5	10	10	90	13
Kaçinar	43	6	12	2	0	0	31	4
Kthelle	71	18	7	2	1	1	63	15
Orosh	66	22	13	6	2	2	51	14
Rreshen	309	83	56	16	22	22	231	45
Rubik	162	38	38	9	16	16	108	13
Selite	56	17	7	1	1	1	48	15


Grafik 6: Zonat ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara

Njësiti administrative Rrëshen, Rubik dhe Fan kanë numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara.

Në grafikun 6 gjeni shpërndarjen gjeografike të individëve me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Mirditë. 21% e personave me aftësi të



kufizuara janë fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç. Nevojat e tyre për shërbime janë të ndryshme nga ato të personave madhorë. Në këto kushte është e nevojshme analiza e këtij grupi.



Grafik 7 Fëmijë me aftësi të kufizuara

Referuar numrit të fëmijëve të grupmoshës 0-18 vjeç në Bashkinë Mirditë (7982 fëmijë), konkludojmë se 2,1% e fëmijëve në Bashkinë Mirditë kanë një aftësi të kufizuar e për rrjedhojë kanë nevoja për shërbime specifike të kujdesit shoqëror.

34% e fëmijëve me AK jetojnë në territorin e njësisë administrative Rrëshen, 17% e tyre jetojnë në njësinë administrative Rubik, në Fan 14%, Oros 12%, Kthellë 10%, Kaçinar 7% dhe në Selitë jetojnë 6% e fëmijëve me aftësi të kufizuara.


Tabela 7. Fëmijë me aftësi të kufizuara sipas grupmoshave

NJËSIA ADMINISTRATIVE	SIPAS GRUP-MOSHAVE			
	Gjithsej	0-6 vjeç	6-15vjeç	15-18
Fan	25	2	14	9
Kaçinar	12	4	4	4
Kthelle	17	1	10	6
Oros	20	2	8	10
Rreshen	60	5	35	20
Rubik	30	2	20	8
Selite	10	2	4	4
Total	174	18	95	61

Invalidët e punës janë një tjetër grup të cilët përveç pensionit të invaliditetit përfitojnë edhe një pagesë nga programi i mbrojtjes sociale. Janë 853 invalidë pune në Bashkinë Mirditë. Shpërndarja e tyre në territor sipas njësive administrative jepet në grafikun 8.

42% e invalidëve të punës jetojnë në njësinë administrative Rrëshen, 23% e tyre jetojnë në njësinë administrative Rubik. Në njësitë e tjera administrative i gjejmë në përqindje më të vogël.

Grafiku 8: Invalidët e punës sipas njësive administrative



Fëmijët me aftësi të kufizuara përbëjnë 2,1% të fëmijëve në Bashkinë Mirditë dhe 21% të personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki. Nevojat e tyre për shërbime duhen vlerësuar dhe duhen konsideruar me prioritet, pasi ndërhyrja që në moshë të hershme, jo vetëm përmirëson cilësinë e jetës për ta dhe familjet e tyre, por edhe krijon

kushtet për integrimin e tyre më të lehtë në shoqëri në të ardhmen. Në çdo njësi administrative ka fëmijë me aftësi të kufizuara, por në përqindje më të lartë ata jetojnë në Rrëshen, Rubik dhe Fan.

Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët


Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social për vitin 2019 raporton 23 raste të menaxhuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje specifike: 14 raste fëmijë të shfrytëzuar/dhunuar, 2 raste të fëmijëve pa kujdes të përkohshëm prindëror dhe 7 raste të fëmijëve jetim. Rastet e fëmijëve të raportuara si fëmijë të dhunuar/shfrytëzuar janë kryesisht raste të fëmijëve të pajisur me urdhëra mbrojtje bashkë me nënat e tyre viktime të dhunës në familje. Në tabelën 8 prezantohen të dhënat për fëmijë në situatë vulnerabiliteti e që kanë të nevojshëm të paktën një formë shërbimi kujdesi shoqëror.

Tabela 8. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Njësia administrative	Fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm	Fëmijë të dhunuar/shfrytëzuar (dhuna/trafikimi)	Jetimë	Fëmijë në familje me NE	Fëmijë me AK
Fan	0	5	0	204	25
Kaçinar	0	0	0	74	12
Kthellë	0	0	0	116	17
Orosh	0	1	0	71	20
Rrëshen	2	2	5	206	60
Rubik	0	2	0	105	30
Selite	0	4	2	64	10
TOTAL	2	14	7	840	174

Siç shihet nga kjo tabelë mes fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje përqindjen më të lartë e zënë fëmijë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (81%) dhe fëmijë me aftësi të kufizuara (17%).

Grafiku 9. Fëmijë në nevojë për mbrojtje e përkujdesje



Siç vihet re edhe nga grafiku numri më i lartë i rasteve në nevojë për mbrojtje e përkujdesje të identifikuar janë në territorin e njësive administrative Rrëshen, Fan, Rubik dhe Kthellë.

Megjithatë numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje mund të jetë më i lartë. Në Bashkinë Mirditë ka vetëm një punonjës së mbrojtjes së fëmijës që kryen edhe detyra të koordinatorit për masa kundër dhunës në familje. Ngarkesa e madhe e punës, personeli shumë i vogël për menaxhimin e rasteve e bën të pamundur identifikimin proaktiv në terren të të gjitha rasteve të fëmijëve që mund të kenë nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Dhuna në familje


Për të identifikuar numrin e rasteve të dhunës në familje u kërkuan dhe u mbledhën të dhëna nga tre institucione lokale: Bashkia, Policia dhe Shëndetësia. Të dhënat u mbledhën për dy vitet më të fundit: 2018 dhe 2019.

Vihet re se në Bashkinë Mirditë viktimat i drejtohen në masën dërmuese Policisë për tu pajisur me Urdhër të mënjehershëm mbrojtje apo urdhër mbrojtje. Në Bashki ato kërkojnë mbështetje vetëm për përfitimin e masës së ndihmës si viktimat të dhunës në familje.

Për vitin 2018 janë rrëgjistruar 12 raste të dhunës në familje, ndërsa për vitin 2019 janë rrëgjistruar 11 raste dhune. Sikurse theksuam tek analiza për fëmijët në nevojë për mbrojtje ka raste kur bashkë me nënën edhe fëmijët janë viktime e dhunës në familje.

Edhe pse numri i rasteve në të dy vitet është pothuajse i njëjtë, siç shihet në grafikun 13 ka rënie të numrit të rasteve në Rrëshen krahasuar me 2018 dhe rritje të rasteve në Rubik dhe Fan. Në konsultimin e zhvilluar me aktorë publik e jo publik, lokalë e rajonalë, u theksua se numri i raportuar i rasteve nuk pasqyron realitetin e dhunës në familje në territorin e Bashkisë. Numri i rasteve të dhunës është më i lartë, por viktimat nuk e raportojnë . kryesisht për shkak të mentalitetit dhe kjo veçanërisht në fshatra.

Grafiku 10: Rastet e dhunës në vitet 2018 dhe 2019 sipas njësive administrative



2.6 Mungesa e strehimit

Drejtoria e Urbanistikës është përgjegjëse për çështjet e strehimit në Bashkinë Mirditë.

Mungesa e strehimit është problem për 187 familje në Bashkinë Mirditë. 77% e familjeve që kanë kërkuar mbështetje nga Bashkia për strehim jetojnë në njësinë administrative Rrëshen. Duket se familjet me shumë anëtarë janë edhe ato që kanë të pamundur të sigurojnë vetë strehimin.

Janë 694 individë, pjesëtarë të familjeve që kanë kërkuar strehim pranë Bashkisë, pra numri mesatar i pjesëtarëve të këtyre familjeve është 3,7. Ndër karakteristikat e tjera të familjeve aplikuese specifikojmë: 6,9% e aplikantëve janë të moshuar; 0,4% janë viktimat e dhunës në familje dhe 9% e familjeve aplikuese janë familje që përfitojnë ndihmën ekonomike.


Tabela 9: Karakteristikat e familjeve që kanë aplikuar për strehim

Njësia administrative	Numri i familjeve që kanë aplikuar/kërkuar për strehim social	Numri i individëve në familjet aplikuese /kërkuese për strehim social	Numri i të moshuarve të vetmuar aplikues/kërkues për strehim social	Numri i viktimave të dhunës në familje që kanë aplikuar/kërkuar strehim social	Numri i familjeve aplikuese për strehim social që përfitojnë ndihmën ekonomike
Fan	7	14	2	0	1
Kaçinar	5	16	3	0	1
Kthelle	4	8	4	0	1
Orosh	12	26	4	0	0
Rrëshen	144	579	28	2	10
Rubik	13	43	7	1	3
Selite	2	8	0	0	1
Totali	187	694	48	3	17

Të moshuarit e vetmuar

Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social raporton për një përfshirje shumë të vogël të të moshuarve në skemën e ndihmës ekonomike (vetëm 60 të moshuar pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike). 48 të moshuar i kanë kërkuar Bashkisë mbështetje për strehim. Nëse i referohemi numrit të të moshuarve (4137) mund të themi që minimalisht 2,6% e tyre kanë nevojë për më shumë mbështetje. Ndërkohë sektori thekson se janë 487 të moshuar në territor që jetojnë vetëm, pasi fëmijët janë në emigracion, si dhe ata kanë të ardhura shumë të vogla.

Divorcet



Për periudhën Janar-Mars 2020 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka regjistruar 34 divorce. Grafiku 11 jep përqindjen e rasteve të divorcit sipas njësive administrative. Siç shihet numri më i lartë i rasteve të divorcit është regjistruar në njësitë administrative Rrëshen, Kaçinar dhe Rubik.

Grafik 11: Rastet e divorcit në territor janar-mars 2020

SHTOJCA 2. NEVOJAT PËR SHËRBIME NË KËNDVËSHTRIMIN E INDIVIDËVE NË NEVOJË DHE TREGUES TË SHËRBIMEVE EGZISTUESE

1. Intervista me individë në nevojë për shërbime



Bashkëshortja ka ndërruar jetë dhe rris i vetëm dy djemtë tanë të moshës 17 dhe 12 vjeç. Prej vitit 2006 përfitoj ndihmën ekonomike. Kam mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme, por nuk kam një profesion. Toka që kam është aq e pakët sa me të nuk arrij as ti ushqej fëmijët. Djali i madh ndjek shkollën e mesme në Rrëshen dhe përveç shpenzimeve të tjera përballoj edhe shpenzimet e transportit. Tërmeti i nëntorit më dëmtoi tërësisht shtëpinë dhe Bashkia më mbështet me bonusin e qerasë. Kam nevojë për punë, sepse është e vetmja mënyrë të rris djemtë, por punë nuk gjej.

Antoni, 51 vjeç



Jam kryefamiljare, nënë e dy fëmijëve 20 dhe 17 vjeç. Prej 15 vitesh jetojmë me ndihmë ekonomike dhe me një pension shumë të vogël të fëmijëve. Kam mbaruar shkollën 8 vjeçare dhe nuk kam ndonjë profesion. Kam qenë disa herë në zyrën e Punës, por asnjëherë nuk kam gjetur punë dhe nuk më kanë përfshirë në kurse profesionale. Përpiqem të punoj në të zezë, që të shtoj të ardhurat. Jetoj me qera dhe me aq pak të ardhura sa kam mezi përballojmë jetesën. Nuk kam informacion se ku të kërkoj bonus qeraje.

Ariana, 40 vjeç





Prej 9 vitesh përfitoj pagesën e aftësisë së kufizuar. Mjekimet i marr me rimbursim, por për mjekët specialistë më duhet të udhëtoj për në Lezhë ose në Tiranë. Jetoj me bashkëshortin dhe me tre fëmijët tanë. Sikurse dhe unë, bashkëshorti nuk punon. Përfitojmë edhe ndihmën ekonomike, por këto janë të pamjaftueshme për ne. Vajza 21 vjeç edhe pse mbaroi me mesatare të lartë shkollën e mesme nuk e ndoqi dot shkollën e lartë, sepse nuk kishim mundësi financiare. Ajo shkoi vazhdimisht tek zyra e punës, por deri tani nuk ka gjetur punë. Jetojmë me stërmundim. Do të doja të paktën të punësohet vajza.

Mariana, 42 vjeç



Kam 30 vjet nëpër spitale. Bashkëshorti është invalid pune dhe djalë 32 vjeçar ka aftësi të kufizuara. Kujdesem për të dy. 15 vjet punova në qendrën ditore për personat me aftësi të kufizuara që ngritën austriakët në Rrëshen, por qendra u mbyll në qershor të vitit të kaluar. Me pagesat që marrim si familje jetesa është e papërballueshme. Trembem se mos bashkëshorti, që është rënduar aktualisht, kalon në dializë dhe nuk do të di çfarë të bëj, sepse duhet shkuar deri në Tiranë për dializën. Do të doja të kisha një punë, edhe pse nuk e di se ku do ta lija djalin e sëmurë. Mu lodhi jeta. Vetëm kur të shkoj tek vorri do çlodhem!

Elize, 58 vjeç





Prej dy vitesh unë dhe gruaja rrisim dy fëmijët e djalit tonë. Ata janë 16 dhe 9 vjeç. Askush përveç nesh nuk mund të kujdeset për ta. Ne jemi pensionistë dhe të ardhurat tona arrijnë në 30.000 lekë në muaj. Kërkuam në Gjykatë që ti marrin fëmijët në kujdestari, por gjykata nuk e miratoi kërkesën tonë. Na konsideron shumë të moshuar për tu kujdesur për fëmijët. Nëse do ti merrnim në kujdestari shteti do të financonte jetesën e fëmijëve me ne çdo muaj. Çfarë mund të bëjmë për ta ne me dy pensione të vogla? Ata duhet të rriten si fëmijët e tjerë. Bashkja na ka ndihmuar me pakë ushqimore edhe gjatë periudhës së pandemisë, por nuk mjafton. Fëmijët kanë nevojë të ndihen si të tjerët. Duhet të gjendet një zgjidhje që fëmijët të përfitojnë pagesën e kujdestarisë. Ne nuk do ti lemë ata në shtëpi fëmijësh, por kemi nevojë për mbështetje.

Pjetër, 70 vjeç



Denoncova dhunën e burrit ndaj meje dhe për një vit kam qenë me urdhër mbrojtje. U divorcova, por isha bashkëshorti vazhdon të më shqetësojë dhe më bën presion. Kam tre fëmijë dhe po i rris me stërmundim. Djali i madh, 16 vjeç, më ndihmon, pasi ndonjëherë gjen punë në të zezë. Jetojmë me ndihmën ekonomike dhe më ndihmon pak edhe mami. Shkoj çdo muaj tek Zyra e Punës, por nuk më gjejnë dot punë. Jetoj në shtëpi me qera dhe e paguaj vetë, sepse askush nuk pranon të më bëjë kontratë dhe të përfitoj bonusin e qerasë. Përveç këtyre paguaj dhe një kredi 4,000 lekë/muaj që e kisha marrë në kohën kur isha bashkëshorti punonte. E vetmja ndihmë që dua është një punë të rris fëmijët e mi.

Esterina, 37 vjeç



Familja jonë përbëhet nga katër pjesëtarë. Unë dhe im shoq punojmë, por rrogat janë të vogla. Nuk kemi shtëpi tonën dhe jetojmë prej vitesh me qera. Kemi aplikuar në Bashki prej dy vitesh për një kredi të butë, që të kemi edhe ne shtëpinë tonë. Nuk na është miratuar kërkesa deri tani. Për 6 muaj Bashkia na ndihmoi me bonusin e qerasë, por më pas na e ndërprente sepse pronarët e shtëpisë që pranonin të na bënin kontratë.

Etleva, 40 vjeç

2. Tregues të shërbimeve egzistuese

Çerdhet, kopshtet dhe shkollat

Çerdhet

Nga 7 njësi administrative, vetëm në 2 prej tyre (Rrëshen dhe Rubik) funksionojnë 2 çerdhe në të cilat marrin shërbim 77 fëmijë.

Tabela 1: Fëmijë në çerdhe

Njësia Administrative	Nr çerdhesh	Nr fëmijesh	Nr. Edukatoresh	Nr fëmijesh për edukatore
Fan	0	0	0	0
Kaçinar	0	0	0	0
Kthelle	0	0	0	0
Orosh	0	0	0	0
Rrëshen	1	66	8	8
Rubik	1	11	3	4
Selite	0	0	0	0
Total	2	77	11	7

Kopshtet

12 kopshte janë funksionale në Bashkinë Mirditë, por ato i përkasin vetëm 2 njësive administrative (Rrëshen dhe Rubik). Në njësitë e tjera administrative nuk ka kopshte. Janë 333 fëmijë që marrin shërbim në 12 kopshtet, për të cilët kujdesen 22 edukatore (15 fëmijë/edukatore).

Përveç dy mencave ku mbështeten familjet më në nevojë, “Caritas” ka ngritur në Rrëshen dhe Fan dy kopshte për fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç. Në Rrëshen kopshti frekuentohet nga fëmijë të komunitetit egjiptian.

Referuar numrit të përgjithshëm të fëmijëve të kësaj grupmoshe (0-6 vjeç) sipas rregjistrit të gjendjes civile (2,356) rrjedh se 17% e fëmijëve marrin shërbim në kopsht dhe çerdhe. Nëse i referohemi censusit rrjedh se vetëm 29% e fëmijëve të kësaj grupmoshe janë të përfshirë në kopshte dhe çerdhe. Në tërësi për kopshtet dhe çerdhet nuk ka masa lehtësuese financiare që të mundësojnë aksesin e fëmijëve të familjeve më në nevojë në to.

Tabela 2: Fëmijë në kopshte

Njësia Administrative	Nr kopshtesh	Nr fëmijesh	Nr. Edukatoresh	Nr fëmijesh për edukatore
Fan	0	0	0	0
Kaçinar	0	0	0	0
Kthelle	0	0	0	0
Orosh	0	0	0	0
Rrëshen	5	247	22	11
Rubik	7	86	10	9
Selite	0	0	0	0
Total	12	333	22	20

Shkollat

Në territorin e Bashkisë Mirditë ka një shkollë profesionale me profile mekanik, elektrik, hidraulik etj. Janë 24 shkolla 9-vjeçare dhe 5 shkolla të mesme. Braktisja e shkollës nuk egziston, ndërsa janë 5 psikologë që mbulojnë të gjitha shkollat në territorin e Bashkisë. Pra është 1 psikolog për 420 fëmijë, në një territor prej 869,71 km². Sikurse duket edhe nga shifrat,

por edhe sipas raportimit të strukturave arsimore në tryezën e konsultimit, edhe pse shërbimi psikosocial funksionon në përputhje me udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse, numri i psikologëve është shumë i ulët dhe në këto kushte është e pamundur të adresohen nevojat për këtë shërbim.

Shkollat 9 vjeçare

Në secilën nga njësitë administrative ka nga 2-6 shkolla 9 vjeçare. Në 24 shkollat 9 vjeçare mësojnë 1621 fëmijë. Duke ju referuar numrit total të fëmijëve të kësaj grupmoshe (7-15 vjec) sipas gjendjes civile që është 4,112 fëmijë, na rezulton se 39% e fëmijëve të kësaj grup moshe ndjekin shkollën 9 vjeçare. Siç kemi theksuar vazhdimisht migracioni dhe emigracioni janë faktorët që japin këtë nivel të përfshirjes në shkolla. Numri i popullsisë de facto në territor është më i ulët se sa ai në gjendjen civile, dhe duke ju referuar censusit 2011 (61% e popullsisë jeton në territor) për rrjedhojë edhe numri i fëmijëve që ndjekin shkollën është në nivelin e 65% referuar totalit të fëmijëve të kësaj grupmoshe.

Tabela 3: Shërbimi psikologjik dhe niveli i braktisjes së shkollës në shkollat 9 vjeçare

Njësia Administrative	Nr. Shkollash	Nr nxënësish	Niveli i Braktisjes së shkollës	Nr mësuesish	Nr psikologësh
Fan	2	211	0	19	1
Kaçinar	2	11	0	6	0
Kthelle	4	81	0	17	1
Orosh	3	100	0	17	0
Rreshen	6	907	0	94	2
Rubik	3	270	0	31	1
Selite	4	41	0	13	0
Total	24	1621	0	197	5

Shkollat e mesme

482 të rinj ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm në 5 shkollat e mesme të kësaj Bashkie. 32% e të rinjve të kësaj grupmoshe ndjekin arsimin e mesëm. Sipas censusit të paktën 51% e të rinjve ndjekin shkollën e mesme. Psikolog janë po ata të raportuar në shkollat 9 vjeçare.

Tabela 4: Shërbimi psikologjik dhe ndjekja e shkollës së mesme

Njësia administrative	Nr. Shkollash	Nr nxënësish	Niveli i Braktisjes së shkollës	Nr mësuesish	Nr psikologësh
Fan	1	61	0	7	1
Kaçinar	0	0	0	0	0
Kthelle	1	28	0	8	1
Orosh	1	24	0	6	0
Rreshen	1	298	0	29	2
Rubik	1	71	0	18	1
Selite	0	0	0	0	0
Totali	5	482	0	68	5

SHTOJCA 3. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shërbimet e kujdesit shoqëror janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror²⁶.

Shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror është rregulluar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Në përputhje me këtë VKM shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në tre grupe:

- Shërbime parashoqërore:** informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *on-line*;

²⁶ Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Neni 3

- b) **Shërbime në komunitet:** shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.
- c) **Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.**

Shporta e shërbimeve përbëhet nga:

1. Informimi dhe këshillimi janë shërbime që synojnë përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.

2. Ndërhyrja e hershme, është një shërbim shoqëror individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet ose institucionet e arsimit të detyrueshëm dhe konsiston në ndihmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç, asistencë këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare, me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës.

3. Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.

4. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

5. Shërbimi multifunksional përfshin një shumëllojshmëri shërbimesh multidisiplinare të specializuara dhe u ofrohet të gjitha kategorive në nevojë.

6. Qendrat ditore ofrojnë shërbim gjysmëditor ose të plotë ditor, të cilat mund të përdoren një ose disa ditë në javë dhe sigurojnë shërbime specifike sipas kategorisë së përfituesve: (i) **fëmijë që jetojnë në situatë rruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike**; (ii) **personat me aftësi të kufizuara**; (iii) të moshuarit;

7. Shërbimi i emergjencës 72 orë u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Ky

shërbim ngrihet për: i. Viktima të dhunës në familje dhe fëmijët; ii. Fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara; iii. të moshuarit apo individë të braktisur në situatë rruge.

8. Shërbimi për të pastrehët ofrohet për individë mbi 18 vjeç që nuk kanë strehë banimi dhe janë në vështirësi ekonomike.

9. Shërbimi i strehimit të mbrojtur u ofrohet viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë. Ai organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.

10. Shërbime në qendrat e zhvillimit, që sigurojnë përmirësimin e statusit dhe të cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.

11. Strehimi afatgjatë, i cili i sigurohet individit që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore. Ky shërbim u ofrohet: **i. Personave me aftësi të kufizuara**; **ii. Të moshuarve dhe të sëmurëve rëndë**, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo familje kujdestare.

12. Shërbimi në strehëza, që u siguron përfituesve shërbim strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim rezidencial ofrohet në mënyrë të përkohshme **(i) për fëmijën** që gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik apo në situatë e rruge; **(ii) për fëmijën në nevojë të mbrojtjes së veçantë**; **(iii) për të rriturin ose të moshuarin** që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten; **(iv) për gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç**; **(v) për fëmijën dhe të rriturin, viktimë të dhunës në familje, të abuzimit, viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit** ose në rrezik të mundshëm për jetën; **(vi) për fëmijën dhe të rriturin në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social**; **(vii) për fëmijën në konflikt me ligjin**.

13. Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese që ofrohen në territorin e bashkisë ose në territorin e rajonit për fëmijë: me çrregullime pervazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik.

14. Rehabilitim për viktimat e abuzimit seksual që ofrohet për viktimën e abuzimit seksual.

15. Strehëza për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, që ofrojnë shërbim në mënyrë të përkohshme, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat e dhunës në familje që kanë marrë urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

16. Qendrën për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, që ofron shërbim në mënyrë të përkohshme.

17. Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar, që ofrohet si shërbim ditor dhe përfshin shërbime rehabilituese sipas nevojave të identifikuara nga njësitë e specializuara mjekësore dhe nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

18. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara.

SHTOJCA 4. BUXHETI I DETAJUAR

Formati excel bashkangjitur